

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5920  
E shtunë, 2 nëntor 2019  
çmimi 0.40 €

Veseli pret sa më shpejt të përfundojë certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## OPINION

### IDENTITETI I USHTRISË ÇLIRIMTARE DHE I KOSOVËS

F. 8

Afërdita  
DERVISHI  
PhDc



### ALFABETI I ATDHEDASHURISË F. 14

Shkruan: Skender HALITI

## AKTUALE

### HARADINAJ: ZAHIR PAJAZITI DHE BASHKËLUFTËTARËT E TIJ JANË SHEMBUJ TË ATDHEDASHURISË F. 9



## EKONOMI

### ABQK-ja RISHIKON TARIFAT E SIGURIMIT PËR VETURA F. 9

### ATK-ja KONFISKON PASURI TË BORXHLINJVE NË VLERË MBI 183 MIJË EURO F. 9

## SPORT

### SOT DERBI FERONIKELI - BALLKANI, DEBUTON TRAJNERI SOPI F. 18

ZËVENDËSNDIHMËSI I SEKRETARIT TË SHBA-SË DHE PËRFAQËSUESI I POSAÇËM PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, MATTHEW PALMER, KA VIZITUAR SHTETIN E KOSOVËS

# PALMERI: QEVERIA E ARDHSHME TA ARRIJË MARRËVESHJEN E NORMALIZIMIT ME SERBINË

## - SHTETËSIA E KOSOVËS ËSHTË E PAKTHYESHME



Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) e inkurajojnë Qeverinë e re të Republikës së Kosovës që, krahas prioriteteve të brendshme, të merret edhe me dialogun me Serbinë dhe me arritjen e marrëveshjes për normalizimin e

raporteve. Kështu ka deklaruar të premten në Prishtinë përfaqësuesi i posaçëm për Ballkanin Perëndimor i Shteteve Bashkuara të Amerikës (ShBA), Matthew Palmer. Ai ka rikonfirmuar qëndrimin amerikan në mbështetje të pavarësisë, duke

thënë se shtetësia e Kosovës është e pakthyeshme dhe tani i duhet normalizimi. Palmeri ka thënë se nuk shihet përparim për integrimin e Kosovës dhe rajonit pa arritjen e marrëveshjes për normalizimin e raporteve me Serbinë

FLET PËR "EPOKËN E RE", FLORIAN DUSHI

FAQE 4-5

## Zgjedhjet e 6 tetorit treguan se reforma zgjedhore është e domosdoshme



Kosova  
nënshkruan  
marrëveshje  
me Lituaninë  
dhe Estoninë  
për  
transportin  
rrugor

FAQE 5

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Gjermania, 30 vjet pas Murit të Berlinit

Rënia e Murit të Berlinit 30 vjet më parë simbolizon rënien e komunizmit në Evropën Lindore që u vendos në këtë rajon pas Luftës së Dytë Botërore nga Bashkimi Sovjetik si dhe i hapi rrugën ribashkimit të Gjermanisë Lindore dhe asaj Perëndimore

**BERLIN, 1 NËNTOR** - Tridhjetë vjet më parë u rrëzua muri i Berlinit, duke i dhënë fund ndarjes mes Lindjes komuniste dhe Perëndimit demokratik. Rënia e murit simbolizon rënien e komunizmit në Evropën Lindore që u vendos në këtë rajon pas Luftës së Dytë Botërore nga Bashkimi Sovjetik. Gjithashtu, i hapi rrugën ribashkimit të Gjermanisë Lindore dhe asaj Perëndimore. Por, partitë e djathta në Gjermaninë Lindore po forcohen, duke kërcënuar sta-

bilitetin e vendit, ka njoftuar "Zëri i Amerikës.

Kur lufta mbaroi në vitin 1945, Berlini ishte një qytet i shkatërruar. Dhe më pas, në vitin 1961, qyteti u nda me një mur, që u ndërtua për ta ndalur ikjen e banorëve të Gjermanisë Lindore drejt Gjermanisë Perëndimore. Sot Muri i Berlinit pothuajse është zhdukur. Pjesët e mbetura të tij shërbejnë si një muze në natyrë dhe miliona njerëz e vizitojnë atë çdo vit.

Në vitet pas rënies së murit,

Berlini Lindor eventualisht arriti një ritëm pothuaj të njëjtë zhvillimi me pjesën perëndimore. Apartamente të reja u ndërtuan në pjesën që dikur ishte Berlino Lindor.

Një rrugë në Berlin njihet si "Damasku i Vogël". Sirianët dhe të ikur të tjerë nga lufta kanë hapur biznese dhe restorante të reja këtu.

Sipërmarrës të tjerë nga e gjithë bota gjithashtu kanë ardhur këtu, duke i dhënë një jetë të re qytetit.

Amerikani Jeremy Minsberg, që drejton një biznes turizmi, është njëri prej tyre. "Papritmas, turistët filluan të vijnë këtu dhe e kuptuan se ky është një vend vërtet i lezetshëm. Ata filluan t'u tregojnë të gjithëve për këtë, dhe zhvillimet rreth Brexit-it kanë nxitur shumë biznese që të

zhvendosen këtu në Berlin", thotë ai.

Por mbishkrimet në mure pasqyrojnë zhgënjimin e disa banorëve të Berlinit se të ardhurit e rinj kanë kontribuar në rritjen dramatike të çmimeve të qirasë. "Gjithçka po bëhet e papërballueshme. Berlino po bëhet si San Francisco. Banorët me të ardhura mesatare nuk mund të konkurrojnë me rrogat e sipërmarrësve të huaj. Kjo po krijon një problem social këtu në Berlin", thotë Jeremy Minsberg, pronar i theberlinexpert.com.

Ekonomia e Berlinit po rritet, por pjesa tjetër e Gjermanisë Lindore nuk ka pasur ritëm të njëjtë zhvillimi ekonomik.

Megjithëse një numër qytetesh në Lindje kanë pasur një zhvillim të suksesshëm ekonomik, shumica e Gjermanisë Lindore

humbi industrinë pas rënies së murit.

Fabrikat e braktisura si këto ishin të zakonshme. Miliona njerëz humbën vendet e punës ose u larguan. "Rreth 80 për qind e gjermanëve nga Lindja humbën vendet e punës pas rrëzimit të murit dhe ribashkimit të vendit. Shumë njerëz ishin të dëshpëruar për të gjetur diçka të re, një punë të re. Shumë njerëz u larguan", thotë Elena Erdman, gazetare e "Die Zeit".

Sipas gazetares Erdmann, ekziston një lidhje e fortë midis rritjes së ekstremizmit të kraut të djathtë dhe rënies së ekonomisë në Gjermaninë Lindore pas ribashkimit të vendit. "Partitë e kraut të djathtë dhe AfD kanë vënë në shënjestër shtetet lindore. Ata kanë qenë jashtëzakonisht të suksesshëm atje", thotë Erdman Zyrtarja e Partisë së Gjelbër, Jana Brix, është e shqetësuar nga rritja e ekstremizmit të kraut të djathtë në vendin e saj. "Për një demokraci të mirë, për një demokraci funksionale ne kemi nevojë për një numër të madh njerëzish të rritur në frymën demokratike, të cilët mendojnë në mënyrë demokratike. Kam frikë se ne do ta humbim atë. Sigurisht që jam e shqetësuar. Akoma nuk i kam humbur të gjitha shpresat. Ende shpresoj. Por ne nuk mund të veprojmë sikur gjithçka është në rregull", tha ajo.

Tridhjetë vjet pas rënies së Murit të Berlinit, të rinjtë si Brix po bëjnë çmos për të ruajtur demokracinë gjermane. Por, siç u demonstrua në një sulm terrorist të ekstremistëve të kraut të djathtë së fundmi kundër një sinagoge në ish-Gjermaninë Lindore, antisemitizmi dhe islamofobia mbeten kërcënime serioze.



## Pendarovski kundër ndryshimit të kufijve

**SHKUP, 1 NËNTOR** - Pasojat në Maqedoninë e Veriut nga vendimi i Samtit të BE-së për mosfillimin e bisedimeve për anëtarësim, propozimi për mbajtje të Samtit të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, anëtarësimi i vendit në NATO, raportet me Serbinë dhe mendimi i tij për ndryshim të kufijve të Ballkanit, ishin temat, në të cilat u përqendrua presidenti Stevo Pendarovski në intervistën për RTS-në, në prag të vizitës së tij në Beograd më 22 nëntor me ftesë zyrtare të shefit të shtetit serb Aleksandar Vučić.

Pendarovski në intervistën e tij u përqendrua edhe në zgjidhjen e çështjes së Kosovës, me ç'rast e theksoi kundërshtimin e tij të idesë për ndryshim të kufijve. "Ekziston një deklaratë imja, e cila ka hasur në reagime nga Qeveria serbe, por kjo është legjitime, nuk kam problem me atë. Unë mbaj llogari për vendin tim. Më me rëndësi është që shteti të mbetet në kufijtë që është. Qëndrimi im është se nuk ka marrëveshje pa bashkësi ndërkombëtare, edhe pse ndikimi i Beogradit dhe i Prishtinës është qenësor. Mendoj se çështja e

Kosovës nuk duhet të mbyllet, e të hapen edhe dy-tre tjera në rajon, të mos ketë efekt domino. Madje edhe kur ndërrohen kufijtë, faktori ndërkombëtar duhet të garantojë se vendimi mes Prishtinës dhe Beogradit do t'u përket vetëm atyre. Edhe pse unë mendoj se do të jetë katastrofë nëse kufijtë fillojnë të ndërrohen në ish-Jugosllavi apo në Evropën Juglindore, mendoj se ky është vendim anakronik. Por, jepni garanci se nuk do të na preket dhe se nuk do të preket integriteti ynë territorial", deklaroi Pendarovski. (Zhumal).



Zëvendësndihmësi i sekretarit të ShBA-së dhe përfaqësuesi i posaçëm për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, ka vizituar shtetin e Kosovës

# Palmeri: Qeveria e ardhshme ta arrijë marrëveshjen e normalizimit me Serbinë

**- Shtetësia e Kosovës është e pakthyeshme, tani i duhet normalizimi i raporteve me Serbinë**

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) e inkurajojnë qeverinë e re të Republikës së Kosovës që, krahas prioriteteve të brendshme, të merret edhe me dialogun me Serbinë dhe me arritjen e marrëveshjes për normalizimin e raporteve. Kështu ka deklaruar të premten në Prishtinë përfaqësuesi i posaçëm për Ballkanin Perëndimor i Shteteve Bashkuara të Amerikës (ShBA), Matthew Palmer. Ai ka rikonfirmuar qëndrimin amerikan në mbështetje të pavarësisë, duke thënë se shtetësia e Kosovës është e pakthyeshme dhe tani i duhet normalizimi. Palmeri ka thënë se nuk sheh përparim për integrimin e Kosovës dhe rajonit pa arritjen e marrëveshjes për normalizimin e raporteve me Serbinë



**EPOKA ERE** Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 1 NËNTOR** - Zëvendësndihmësi i sekretarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe përfaqësuesi i posaçëm për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, të premten ka qëndruar për vizitë në Kosovë, ku është takuar me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, me liderët e partive politike si dhe ka mbajtur një ligjëratë me studentët dhe përfaqësues të shoqërisë civile në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani". Me këtë rast, Palmeri ka rikonfirmuar qëndrimin amerikan në mbështetje të pavarësisë, duke thënë se shtetësia e Kosovës është e pakthyeshme dhe tani i duhet normalizimi. Shtetet e Bashkuara të Amerikës do ta përkrahin gjithmonë sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës, por ne nuk shohim kurrfarë mundësie për integrimin e plotë të vendit tuaj në sistemin ndërkombëtar nëse nuk përfshin pajtimin me Serbinë", ka deklaruar Palmeri. Ai ka thënë se ShBA-ja e nxit qeverinë e re të Republikës së Kosovës që, krahas prioriteteve të brendshme, të merret edhe me dialogun me Serbinë dhe me arritjen e marrëveshjes për normalizimin e raporteve. "Në vend se ta shohim dialogun si shpërqendrim, konsiderojeni normalizimin si trasim për prosperitet dhe drejtësi. Dialogu dhe normalizimi i raporteve me

Serbinë çojnë Kosovën dhe rajonin kah e ardhmja. Marrëdhëniet e përparura dhe përmirësimi i tyre me Serbinë hapin rrugën për investime fitimprurëse që krijojnë vende të reja të punës prej të cilave mund të përfitojë populli i Kosovës. Kur të formohet qeveria me mandat

të ri nga votuesit mundet dhe duhet t'i gjallërojë negociatat", është shprehur Palmeri. Gjatë këtij bashkëbisedimi me studentët dhe përfaqësues të shoqërisë civile, Palmerit iu shtruan pyetje sa i përket afatit kohor për përfundimin e dialogut dhe arritjen e mar-

rëveshjes. "Nuk i takon ShBA-së që të përcaktojë afatin kohor. Kjo u takon palëve. ShBA-ja e mbështet dialogun dhe këtë e themi vazhdimisht. Duam që të dyja palët të arrijnë marrëveshje për normalizimin e plotë të marrëdhënieve. Ne do të jemi këtu dhe do të kërkojmë që ajo

që arrihet si marrëveshje të zbatohet", ka thënë Palmeri, duke shtuar se tash për tash nuk mund të spekulohet nëse dialogu do të vazhdojë në formatin e tashëm apo të një formati si konferenca e Rambujesë apo ajo e Dejtonit.

Palmeri ka folur edhe për zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit, duke thënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbështesin orientimin e votuesve të Kosovës për ndryshime. "Votuesit u shprehën qartë për ndryshim dhe duket se votuesit mbështetën qartë partinë që shprehu qartë parimet kundër korrupsionit si dhe parimet për zhvillimin ekonomik më të madh e më të fokusuar. Edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës i përqafojnë këto qëllime", ka theksuar ai. Sipas Palmerit, sytë e botës janë kah Qeveria e re e Kosovës, duke pritur se çfarë do të bëjë me reformat e brendshme dhe dialogun me Serbinë. "Sytë e botës do të shikojnë se çfarë do të bëjë Qeveria e re e Kosovës. A mund të merret me prioritetet e brendshme të kërkuara nga populli derisa merret me sfidat ndërkombëtare të cilat Kosova duhet t'i zgjidhë për të përparuar. Asaj i duhet një koalicion qeverisës që përfaqëson popullin me një zë koherent dhe objektiva reale dhe me plan se si ta arrijë atë cak", ka thënë Palmeri. Ai ka deklaruar se Amerika dëshiron që Kosova ta ketë një qeveri e cila do t'i adresojë sfidat e brendshme dhe të jashtme. "Shpresojmë të shohim një qeveri e cila do t'i adresojë si sfidat e jashtme ashtu dhe ato të brendshme. Çdo hap i kaluar pas normalizimit do të jetë shumë më i lehtë në rrugë të trasuar me paqe", është shprehur Palmeri.

## Palmeri takoi Thaçin, Mustafën, Veselin dhe Haradinajn



Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të premten përfaqësuesin e posaçëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer. Thaçi dhe Palmeri kanë biseduar për zhvillimet e fundit dhe për nevojën e krijimit të shpejtë të institucioneve të Republikës së Kosovës. Presidenti Thaçi ka thënë se Kosova është e bekuar që ka mbështetjen e vazhdueshme të ShBA-së. "Kosova është një demokraci e konsoliduar, e dëshmuar në zgjedhjet e fundit. Ka institucione të pavarura, të

fuqishme, profesionale dhe liri të shprehjes", ka thënë presidenti Thaçi, duke shtuar se Kosova mbetet e përkushtuar për vazhdimin e reformave për rend dhe ligj, për forcimin e të ardhmes euroatlantike, për reformat demokratike dhe do të angazhohet maksimalisht për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me Serbinë, e cila forcon paqen jo vetëm brenda dy vendeve, por në tërë Ballkanin Perëndimor. Kurse Matthew Palmer ka folur për atë se si Kosova mund ta shtrojë rrugën drejt paqes përmes një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse

me Serbinë.

Edhe kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, së bashku me nënkryetaren Vjosa Osmani, kanë takuar zëvendësndihmësekretarin e Shtetit, Matthew Palmer, në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë. Sipas njoftimit për medie të LDK-së, gjatë këtij takimi janë diskutuar prioritetet për institucionet e ardhshme që lidhen me agjendën e brendshme si dhe politikën e jashtme të Republikës së Kosovës, siç janë sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik dhe dialogu Kosovë - Serbi. "Kryetari Mustafa e ka falënderuar z/ndihmësekretarin Palmer për angazhimin shumë aktiv dhe përkrahjen e Shteteve të Bashkuara si dhe për angazhimin e tij personal për ta përkrahur Kosovën në të gjitha prioritetet dhe sfidat që na presin. Përfaqësuesi special Matthew Palmer foli për atë se si Kosova mund ta shtrojë rrugën drejt paqes përmes një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me Serbinë", është thënë në komunikatë. Palmeri ka takuar edhe kryeministrin në detyrë, Ramush Haradinaj, liderin e PDK-së, Kadri Veseli si dhe zyrtarët e Listës Serbe.



Flet për "Epokën e re", Florian Dushi

# Zgjedhjet e 6 tetorit treguan se reforma zgjedhore është e domosdoshme

Ish-anëtari i KQZ-së, aktualisht anëtar i Kryesisë së LDK-së, Florian Dushi, ka thënë se zgjedhjet e 6 tetorit kanë dëshmuar se reforma zgjedhore është e domosdoshme për ta ruajtur sistemin demokratik dhe parlamentar në Kosovë. Ai ka deklaruar se kjo reformë duhet të jetë prioritet i qeverisë së re. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Dushi ka deklaruar se reforma duhet t'i përfshijë elementet të cilat do ta ruanin të pacenuar integritetin e zgjedhjeve që është cenuar së fundmi. Kurse sa i përket vendimit të Gjykatës Supreme për votat e ardhura me vonesë nga diaspora, ka thënë se është i diskutueshëm sepse, sipas Dushit, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme është shumë i qartë në këtë drejtim. Ndërsa për votat e dyshimta që kanë ardhur në zarfe nga Serbia, ai ka thënë se KQZ-ja duhet të vendosë në përputhje me Kushtetutën dhe parimet themelore të përcaktuara në ligj

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 1 NËNTOR -

**"Epoka e re":** Z. Dushi, si e keni parë vendimin e Gjykatës Supreme me të cilin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) obligohet që t'i numërojë mbi 4 000 vota të ardhura nga diaspora me vonesë dhe si duhet të vepohet më tutje?

**Dushi:** Vendimi i fundit i Gjykatës Supreme rreth fletëvotimeve të ardhura me vonesë në KQZ është në vazhden e vendimeve të diskutueshme të këtij organi gjyqësor. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme është tejet i qartë në këtë drejtim, duke saktësuar procedurën sikur edhe afatet brenda të cilave duhet të realizohet kjo e

drejtë kushtetuese nga ana e qytetarëve tanë. Ata që e kuptojnë mirë dhe drejtë natyrën periodike të zgjedhjeve, afatet kushtetuese për konstituimin e organeve që dalin nga këto zgjedhje, e dinë se afatet në zgjedhje janë tejet të rëndësishme dhe kjo e drejtë kushtetuese, sipas Kushtetutës, por edhe sipas konventave ndërkombëtare të cilave iu referohen vetë ata, nuk është e pakufizuar në kohë dhe e papërcaktuar si procedurë, ndryshe ne nuk do të kishim zgjedhje periodike, por të vazhdueshme, në pritje të përhershme të arritjes eventuale të ndonjë vote nga jashtë! Flas në aspektin profesional dhe ligjor, përndryshe ata që presin ose kanë interesa

subjektive nga këto fletëvotime, kanë provuar që këtij procesi t'i japin edhe konotacion patriotik.

**"Epoka e re":** KQZ-ja ka pranuar edhe votat në zarfe të ardhura në mënyrë të paligjshme nga Serbia, madje ato janë numëruar në kushte të jashtëzakonshme nga rreziku për helmim.

**Dushi:** Po, ne kemi përvoja edhe nga proceset e mëhershme dhe nga kjo përvojë ne kemi parë dhe kuptuar pa asnjë dilemë se ato janë vota të manipuluar sipas të gjitha gjasave nga një qendër e vetme diku në Serbi, nga një qendër e cila ka dhe keqpërdor të dhënat e qytetarëve serbë të Republikës së Kosovës të cilët



të analizohet dhe të trajtohet lidhur me këto zgjedhje. Që nga vendimet e organeve që janë të autorizuar të shqyrtojnë dhe vendosin lidhur me ankesat dhe që përmes vendimeve të tyre kanë sjellë interpretime të reja që bien ndesh me praktikën e KQZ-së, praktika këto të ndërtuara në mbështetje të plotë ligjore, deri te veprimet e vet KQZ-së, sikur rasti i ngritjes së nivelit të tolerancës në një vendvotim në plus/minus 450 vota që është në kundërshtim me rregullat zgjedhore, veçanërisht abuzimi me votat e kandidatëve nga ana e kryesuesve dhe anëtarëve të këshillave të vendvotimeve që duket se në disa raste kanë qenë të shtyrë/porositur për ta bërë një gjë të tillë, kanë bërë që të kemi vonesa në përpilimin dhe shpalljen e rezultateve përfundimtare nga ana e KQZ-së, të cilat prapë frikësohem se nuk do të jenë korrekte nisur nga ajo çfarë kemi parë të ketë prodhuar rinumërimi i deritashëm.

**"Epoka e re":** Një reformë e mirëfilltë zgjedhore, a do t'i shmanget këto gabime si dhe do ta avanconte procesin zgjedhor?

**Dushi:** Unë vazhdimisht kam kërkuar të kemi një reformë të mirëfilltë zgjedhore, por këto zgjedhje kanë treguar se ajo tashmë është e domosdoshme për ta ruajtur të pacenuar sistemin demokratik e parlamentar në vendin tonë për ta ruajtur, në fund të fundit, qëllimin pse zgjedhjet organizohen në një vend. Institucionet tona, subjektet politike, duhet me urgjencë dhe seriozitet ta nisnin këtë proces, duke marrë për bazë dhe përshtatur nevojat të vendit tonë, standardeve dhe praktikave më të mira të shteteve të cilat tashmë kanë arritur të ndërtojnë, konsolidojnë dhe avancojnë sistemin e tyre demokratik, duke përfshirë edhe rekomandimet e misionëve të vëzhguesve të BE-së.

**"Epoka e re":** Reforma zgjedhore mendoni se duhet të jetë një ndër prioritetet e qeverisë së re?

**Dushi:** Reforma zgjedhore duhet të jetë prioritet i qeverisë së re, por është përgjegjësi e të gjitha subjekteve politike në vendin tonë. Qytetarët e Kosovës me të drejtë presin që ky sistem të përmirësohet, të avancohet në kuptimin e përbushjes së qëllimit dhe misionit të zgjedhjeve në vendin tonë. Reforma duhet të përfshijë elemente të forta të cilat do ta ruanin të pacenuar integritetin e zgjedhjeve, i cenuar së fundmi dhe i kërcënuar në të ardhmen nga të njëjtët faktorë për të cilët folëm më sipër.

gjenden atje, e që trajtohen nga institucionet shtetërore atje si refugjatë. Këto dërgesa, zarfet, fletëvotimet dhe mënyra e ardhjes së tyre nga Serbia, përbëjnë bazë të mjaftueshme për dyshim për atë çfarë e thashë më sipër. Shtoja kësaj faktin që të gjithë këta 'votues' përmes postës kanë votuar për vetëm një subjekt të vetëm politik "Listën Serbe" (ndërkohë që kishim 4 subjekte politike të certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje) që është një instrument politik dhe jo vetëm, i Qeverisë së Serbisë në Kosovë, dyshimi rritet akoma më shumë. Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha këto, konsideroj se KQZ-ja do të duhej t'i trajtojë këto fletëvotime në përputhje me Kushtetutën dhe parimet themelore të përcaktuara në Ligjin për Zgjedhje të Përgjithshme dhe të vendosë në frymën e këtyre parimeve për këto fletëvotime.

**"Epoka e re":** Ndonëse procesi zgjedhor i 6 tetorit u cilësua ndër më të mirët të mbajtur në Kosovë, megjithatë është përcjell me disa gabime teknike dhe njerëzore. Cilat mendoni se kanë qenë arsyt që kanë sjellë këto gabime dhe vonesa në publikimin e rezultateve përfundimtare?

**Dushi:** Ka shumëçka që duhet

## Veseli pret sa më shpejt të përfundojë certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve



**PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER)** - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka pritur të premten në takim zëvendësshefin e misionit vëzhgues të BE-së, Marian Gabriel. Në këtë takim që u zhvillua në zyrën e liderit të PDK-së u diskutua për mbarë-

vajtjen e procesit zgjedhor në Kosovë. Pas këtij takimi, Veseli në faqen e vet në "Facebook" ka shkruar se me zëvendësshefin e misionit vëzhgues të BE-së ka diskutuar edhe për sfidat që e kanë përcjellë procesin zgjedhor në Kosovë. "Me zëvendësshefin e misionit vëzhgues të BE-së,

Marian Gabriel, diskutuam përgjithësisht për procesin zgjedhor si për mbarëvajtjen dhe për sfidat që e kanë përcjellë. Presim përfundimin sa më të shpejtë të këtij procesi pasi që qytetarët e Kosovës duhet t'i kenë adresat për nevojat e tyre", ka shkruar Veseli.

## Kosova nënshkruan marrëveshje me Lituaninë dhe Estoninë për transportin rrugor

**PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER)** - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka pritur të premten në takim zëvendësshefin e misionit vëzhgues të BE-së, Marian Gabriel. Në këtë takim që u zhvillua në zyrën e liderit të PDK-së u diskutua për mbarëva-

jtjen e procesit zgjedhor në Kosovë. Pas këtij takimi, Veseli në faqen e vet në "Facebook" ka shkruar se me zëvendësshefin e misionit vëzhgues të BE-së ka diskutuar edhe për sfidat që e kanë përcjellë procesin zgjedhor në Kosovë. "Me zëvendësshefin e misionit vëzhgues të BE-së,

Marian Gabriel, diskutuam përgjithësisht për procesin zgjedhor si për mbarëvajtjen dhe për sfidat që e kanë përcjellë. Presim përfundimin sa më të shpejtë të këtij procesi pasi që qytetarët e Kosovës duhet t'i kenë adresat për nevojat e tyre", ka shkruar Veseli.



## Shkolla e Vërmicës në Malishevë bëhet me kabinet të biologjisë

**MALISHEVË, 1 NËNTOR (ER)** - Agjencia për Financim në Kosovë (AFK) i ka dhuruar shkollës në Vërmicë të Komunës së Malishevës pajisje për kabinetin e biologjisë. Në dhurimin e donacionit nga ana e AFK-së, përkatësisht nga përfaqësuesi i tyre, Avdullah Bytyçi, ishte i pranishëm edhe drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim në Malishevë, Blerim Thaçi, i cili i ka falënderuar për këtë donacion të radhës, me rëndësi të madhe. "AFK-ja në vazhdimësi i

përkrah institucionet shkollore në komunën tonë dhe ky donacion është në vazhdim të kësaj përkrahje të vazhdueshme. Këto pajisje të dhuruara sot kanë rëndësi të madhe për zhvillimin e orës së biologjisë, pasi edhe nxënësit do ta kenë më të lehtë ta kuptojnë lëndën. Në emër të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim e falënderoj Agjencinë për Financim në Kosovë për këtë përkrahje të vazhdueshme", ka thënë Thaçi. Ndërsa përfaqësuesi i AFK-së

në Malishevë, Avdullah Bytyçi, pasi e ka dorëzuar donacionin, ka thënë se janë të kënaqur që kanë mundësi t'i përkrahin institucionet shkollore. "Përkrahja në fushën e arsimit është me rëndësi për ne dhe këto përkrahje do të jenë të vazhdueshme", ka thënë ai. Ndërsa ushtruesi i drejtorit i shkollës në Vërmicë, Tahir Gashi, ka falënderuar AFK-në për këtë donacion shumë domethënës për shkollën e tyre pasi, sipas tij, tani nxënësit, përveç mësim



teorik, do të kenë mundësi që edhe në praktikë ta mësojnë lëndën. Donacioni i AFK-së për këtë shkollë përfshin mikroskop dhe të gjitha pjesët e trupit të njeriut.

## Dy persona tentuan të transportojnë 15 kilogramë marijuanë në Serbi

**GJILAN, 1 NËNTOR (ER)** - Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka kërkuar nga Gjykata Kompetente në Gjilan caktimin e masës së paraburgimit ndaj të dyshuarve F. H. dhe A. N., me dyshimin se kanë kryer veprën penale "Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge". Sipas kërkesës,

ekziston dyshimi i bazuar që, më 8 shtator 2019, rreth mesnatës, të dyshuarit, në bashkëveprim, me dashje dhe pa autorizim, kanë transportuar substancë narkotike të llojit "marijuanë", në peshë prej 15 kilogramësh, të cilën e kanë pasur të mbështjellë në një valixhe.

Të dyshuarit janë marrë vesh që këtë substancë narkotike përmes pikës kufitare "Dheu i Bardhë" ta transportojnë në

Republikën e Serbisë mirëpo, pasi janë afruar te pika kufitare, nga frika që të mos hetohen nga organet e ndjekjes, në një distancë prej 500 metrash, të njëjtën e kanë hedhur nga dritarja e automjetit, me qëllim që t'i shmangen identifikimit të tyre, ku më 31 tetor 2019 janë identifikuar dhe arrestuar. Në këtë rast është i përfshirë edhe një person i dyshuar, i cili gjendet në arrati.



## Aliu: Drogat janë kërcënimi ynë



**FERIZAJ, 1 NËNTOR (ER)** - Drogat çdo ditë po kërcënojnë shoqërinë tonë, veçanërisht të rinjtë. Me këtë qëllim dhe për ta hapur muajin e vetëdijesimit kundër narkotikëve në Ferizaj të premten është mbajtur konferenca "Nëntori, muaj i vetëdijesimit kundër substancave narkotike", e cila është organizuar nga Qendra "Këshillimi" dhe është mbështetur nga Komuna e Ferizajt. Organizatorja e kësaj ngjarje, Arjeta Musliu, e cila e ka humbur të birin nga përdorimi i substancave narkotike, duke folur për punën e këtij institucioni dhe sfidat që e përcjellin këtë fenomen, në veçanti familjet e të rinjtë ku hasen këto raste, ka thënë se që nga hapja e Qendrës "Këshillimi"

ka ofruar shërbime profesionale për 150 raste, shifër kjo alarmuese për numrin në rritje të përdoruesve të narkotikëve. Ndërsa kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, ka thënë se kjo komunë, ndonëse me kufizime në infrastrukturën sociale, ka vullnetin e plotë institucional për t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për luftimin e këtij fenomeni. "Unë jam luftëtar bashkë me ju! Çdo armë në duart e mia është edhe e juaja, kundrejt narkotikëve që helmojnë fëmijët tanë", ka thënë Aliu. Ndërsa eksperti i psikoterapisë, Migjen Amzai, vullnetar i Qendrës "Këshillimi", ka ndarë përvojat e tij dhe sukseset që ka shënuar kjo qendër për pak muaj.

## Vihet gurthemeli i çerdhes në Krushë të Madhe të Rahovecit

**RAHOVEC, 1 NËNTOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka marrë pjesë në vendosjen e gurthemelit të çerdhes në Krushë të Madhe. Ai ka treguar se ky projekt është investim i Komunës së Rahovecit dhe kap vlerën mbi 294 mijë euro. "Në kuadër të zotimeve tona kryesore para qytetarëve të komunës së Rahovecit që të kemi sa më shumë infrastrukturë për edukimin e hershëm, sot kemi vënë gurthemelin e projektit

shumë të rëndësishëm: ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në Krushë të Madhe. Ky projekt është investim i Komunës së Rahovecit dhe kap vlerën: 294,290.60 euro", ka deklaruar Latifi.

Ai ka thënë se edukimi i fëmijëve është prioritet i qeverisjes së tij. "Vendosja e fëmijëve nëpër sallat e ditës, ngrohja për ta si dhe përshtatja e mjediseve të jashtme janë disa prej elementeve përcjellëse të këtij projekti që shprehin vendosmërinë tonë për t'i qën-

druar premtimit të ndërtimit me standarde evropiane të çerdheve në Komunën e Rahovecit. I përgëzoj dhe i uroj të gjithë qytetarët e Krushës së Madhe dhe fshatrave përreth për këtë objekt me rëndësi të veçantë, ku do të përfitojnë përkrahjen më të rëndësishme për fëmijët e tyre dhe ne të gjithë bashkë për qytetarët tanë. Edukimi është e drejtë themelore për fëmijët, kurse për mua dhe qeverisjen time është prioritet i lartë", ka thënë Latifi.



## Haradinaj: Zahir Pajaziti dhe bashkëluftëtarët e tij janë shembuj të atdhedashurisë

PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë homazhe të premtën dhe ka vendosur kurora me lule te shtatorja e heroit Zahir Pajaziti, në ditëlindjen e 57 të tij. I shoqëruar nga familjarë dhe bashkëluftëtarë të

heroit Zahir Pajaziti, kryeministri në detyrë, Haradinaj, ka thënë se Zahiri dhe bashkëluftëtarët e tij janë shembuj të atdhedashurisë dhe vetëmohimit, në kërkim të lirisë dhe të drejtës së shqiptarëve. "Në ditëlindjen e heroit të kombit Zahir Pajaziti bëmë

nderim simbolik me familjarë dhe kolegë në shenjë nderimi dhe respekti për kontributin për liri", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se respekti ndaj veprës së luftëtarit të çmuar shqiptar, komandantit tonë, Zahir Pajaziti, mbetet i pavdekshëm.



## Për gjashtë muaj 59 aktakuza për prerje të pyllit në Pejë

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PEJË, 1 NËNTOR - Nën organizimin e Prokurorisë Themelore të Pejës, mbështetur nga misioni i OSBE-së në Kosovë, të premtën është mbajtur tryeza e dytë gjatë këtij viti me temën "Degradimi i pyjeve dhe ambientit". Kjo tryezë e udhëhequr nga kryeprokurori Agim Kurmehaj kishte për qëllim prezantimin e të arriturave prej tryezës së mbajtur në muajin prill të këtij viti, gjetjen e mekanizmave efikas në luftimin e këtyre dukurive dhe koordinimin sa më të mirë në këtë drejtim, ku të pranishëm ishin kryetarët dhe përfaqësuesit e pesë komunave (Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik), zinxhiri komandues i Policisë së Kosovës në rajonin e Pejës, përfaqësues të pylltarisë dhe minierave dhe



mineraleve dhe shoqërisë civile. Lidhur me progresin e arritur gjatë këtyre gjashtë muajve kryeprokurori Agim Kurmehaj ka thënë se ka pasur rezultate të dukshme gjatë këtyre gjashtë muajve, mirëpo ka theksuar se kjo dinamikë e punës duhet të

vazhdojë nga të gjitha institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e ambientit. Gjithashtu, gjatë kësaj tryeze u prezantuan të dhënat e Prokurorisë Themelore të Pejës nga prokurori i shtetit Ersan Qavolli, i caktuar si koordinator i këtyre veprave penale.

Për gjashtë muaj kjo prokurori, ka ngritur gjithsej 59 aktakuza kundër 66 personave për veprën penale "Vjedhje e pyllit", ndërsa ka sekuestruar 256.24 m<sup>3</sup> masë drusore, 19 kamionë, nëntë kombi, dhjetë automjete, shtatë traktorë dhe gjashtë motorë

sharra për dallim nga viti i kaluar ku të sekuestruara ishin vetëm një kamion dhe një traktor. Në fund të kësaj tryeze nga të pranishmit u propozuan konkluzione të ndryshme të cilat do shërbejnë për mbrojtjen e ambientit, në veçanti pyjet dhe lumenjtë.

## Lufta kundër korrupsionit, në fokus të takimit Hyseni - Havolli



PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni, ka pritur në takim drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havolli, me ç'rast kanë diskutuar për sundimin e ligjit në Kosovë, me fokus të veçantë për zbatimin e tri ligjeve që ndërlidhen me luftën kundër korrupsionit. Me këtë rast është biseduar për Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në

ushtrimin e funksionit publik, Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe Ligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë. Kryesuesi Hyseni dhe drejtori Havolli kanë thënë se zbatimi i këtyre ligjeve është shumë i rëndësishëm për sistemin e drejtësisë në Kosovë, prandaj shtrohet nevoja e një koordinimi

të vazhdueshëm të institucioneve për arritjen e sukseseve. Rrjedhimisht, bashkëbiseduesit kanë diskutuar edhe çështje të tjera të interesit të përbashkët institucional për luftimin e korrupsionit dhe veprimeve antiligjore. Në fund të takimit u vlerësua lart bashkëpunimi i deritashëm KPK-AKK, duke shprehur gatishmërinë e thellimit të tij, me qëllim të sundimit të rendit dhe ligjit në Kosovë.

## Rama njofton zëvendës-presidenten e Senatit francez për misionin e ri të FSK-së

PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtnant Rahman Rama, ka pritur në takim zëvendës-presidenten e Senatit të Francës, Helen Corway Mouret. Gjeneral Rama ka falënderuar atë për ndihmën e vazhdueshme dhe profesion-

ale që Franca i ka dhënë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës. Gjithashtu, komandanti i FSK-së gjatë takimit e ka njoftuar senatoren Mouret lidhur me misionin e ri të FSK-së si dhe me arritjet e përgjithshme të saj në fushën e arsimit, trajnimeve

dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar me shtetet partnere dhe anëtare të NATO-s. Ndërkaq Mouret ka falënderuar komandantin e FSK-së për pritjen dhe e ka uruar atë për sukseset për ndërtimin e një force të besueshme, profesionale dhe gjithëpërfshirëse.



(Kumtesë në konferencën shkencore: "Kosova 20 vjet liri dhe përpjekje", organizuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik dhe Instituti Albanologjik i Prishtinës, më 10. 06. 2019)

# IDENTITETI I USHTRISË ÇLIRIMTARE DHE I KOSOVËS



**Afërdita DERVISHI Ph.Dc**  
Profesoreshë/Hulumtuuese  
shkencore

## Çështje të përkufizimit

Nëse flitet për identitetin e dy a më shumë palëve, që është në këtë rast, a mund të thuhet se ka dyfishim të identiteteve, që ose e përjashtojnë njëri-tjetrin, ose janë të ndërthurur deri në atë masë, sa nuk mund të flitet për identitete të ndryshme. Prandaj, identiteti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është lufta e saj çlirimtare, kurse rrjedhojë e asaj lufte është liria e kësaj pjese të atdheut, që quhet Shqipëri, sepse Shqipërisë i janë shkëputur pjesë të tokave, që i kanë marrë pushtues të ndryshëm.

Atëherë, cili është identiteti i Kosovës, sidomos pas Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës? Identiteti kombëtar i saj, zë fill që në shekullin XV-të, me luftërat afro 30 vjeçare të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut, po ashtu që në kohën e ekzistimit të Vilajeteve shqiptare, më tutje, edhe me formimin e krahut ushtarak të Lidhjes Shiptare të Prizrenit, si dhe ishte përmbyllur me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, më 1912, nga Ismail Qemali. Do të thotë, identitetin kombëtar të saj, nuk e ka përcaktuar Lufta e UÇK-së. Identiteti i UÇK-së ka krijuar hapësirë, po ashtu në marrëveshje me fuqitë e mëdha botërore, të krijohet identiteti shtetëror i Kosovës, i cili si proces historik në rrugën e bashkimit kombëtar, është hapur me Luftën e UÇK-së.

## Hyrje

Kur çështjet shtrohen në këtë rrafsh, atëherë mund të thuhet se këto dy identitete, ai i Luftës së UÇK-së, dhe ai i Kosovës, nuk kanë të njëjtin taban historik, por kanë të njëjtën zgjidhje politike. Identiteti i UÇK-së, pra, edhe i luftës së saj çlirimtare, gjatë zhvillimit të saj, gjatë organizimit të saj, edhe në frontet e luftës, ka pasur rënie dhe ngritje, të shumtën të kushtëzuar edhe nga rrethanat e

brendshme, edhe nga faktorët e jashtëm.

Rrethanat e brendshme ishin pasojë e gjendjes okupuese të Kosovës, por ishin edhe pasojë e kuptimeve të ndryshme të rrugëve për bërjen e lirisë.

Faktorë të rëndësishëm të brendshëm, pra faktorë brenda Kosovës dhe brenda hapësirës shqiptare, nuk e pranin as luftën çlirimtare, as ushtrinë që bënte këtë luftë çlirimtare, pra Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, siç është quajtur që në fillimin e organizimit të saj në luftën frontale. Më tutje, si pasojë e pushtimit të gjatë, Kosova nuk kishte as shtet, as pushtet, edhe pse sot e gjithë ditën shtesa të caktuara shoqërore derdhen lot krokodili, për atë që është prishur e nuk po rregullohet asnjëherë, në kohën e vëllazërimit dhe bashkimit socialist, duke i rënë telit të mendësisë se liria do të vinte pa luftë, se do të vinte nga qielli, apo nga diku jashtë, apo siç e ka thënë Holbrook, nga një supremen, e nuk do të kishte nevojë të derdhej tërë ai gjak e të shkatërrohej gjithçka në Kosovë.

Faktori i jashtëm, sidomos qendrat e vendosjes evropiane, duke bërë përpjekje që ta ruanin qetësinë e tyre, pra të Evropës, njësoj si edhe në vitin 1913, kur ishte përgjakur copëtimi i tokave shqiptare, nuk hezitonte ta quante edhe konflikt të brendshëm, nuk hezitonte të kërkonte nga ata që ishin vetëshpallur si përfaqësues të Kosovës, që të disiplinoheshin formacionet ushtarake, të mos vriteshin policia dhe ushtria jugosllave, pastaj ajo serbo-malazeze, të mos shkeleshin konventat ndërkombëtare, si dhe e drejta ndërkombëtare, se shteti që e konsideronte Kosovën pjesë të veten, kishte të drejtë edhe të bënte masakra, kur brenda atij territori shtetëror, shpallej padëgjueshmëri qytetare.

Qendrat evropiane të vendosjes, duke ruajtur lëkurën e vetë, nuk merreshin fare me zgjidhjen e çështjes shqiptare, të cilën e kishin krijuar vetë, siç nuk merren as sot, e nuk do të merren as nesër, sidomos nëse SHBA heq dorë nga projekti i saj për zgjidhjen e çështjes shqiptare.

Prandaj, identiteti i Kosovës është çështje që kërkon zgjidhje, sipas të drejtës historike të popullit shqiptar, sepse siç po shihet, identiteti shtetëror nuk mjafton për të përmbyllur procesin e bashkimit kombëtar, që ishte ideologjia identifikuese e Luftës së UÇK-së.

## Një ushtri që bënte luftë çlirimtare pa shtet dhe pa pushtet

Historiani ushtarak Alan Millet, pohon se identiteti i luftëtarit është pjesërisht i trashëguar dhe pjesërisht i vetëzhvilluar. Veprimtarët e devotshëm të çështjes kombëtare, në kushte dhe rrethana të jashtëzakonshme, në kohë të rënda plumb, e formuan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, dhe, aty e gjetën veten e tyre si ushtar të një ushtrie, pa shtet dhe pa pushtet.

Nëse ky konstatim qëndron, gjë që e thonë edhe faktet historike të zhvillimit të ngjarjeve në atë kohë, atëherë çka ishte kjo ushtri që bënte luftë çlirimtare? Ishte një ushtri e dalë nga populli, sidomos nga shtesa atdhetare e popullit, e organizuar në mënyrë vullnetare, pa shtet, sepse Kosova ishte e pushtuar dhe nuk ishte shtet, si dhe pa pushtet, sepse pushteti që thuhej se ekzistonte brenda Kosovës, nuk e kishte mbështetjen e krahut të luftës, rrjedhimisht nuk e kishte mbështetjen e shtresave më të gjera të popullit. Këtë e dëshmon një fakt i vetëm historik, ai i daljes publike të UÇK-së, në varrimin e mësuesit Halit Geci. Ata që kanë përcjellë ato skena, nuk mund të shkelin mbi faktin e gatishmërisë së shtresave të popullit që të përballen me armikun.

Po ashtu, fjalia që është thënë aty, se ky popull tashti e tutje e ka forcën e vetë që i mbron, e ka ushtrinë e vetë, dëshmon për identitetin çlirimtar të saj. Do të thotë, deri atëherë Kosova nuk kishte një forcë që mund të dilte para popullit dhe të thoshte se tashti e tutje, ka kush u mbron nga pushtuesi.

Në këtë rrafsh, identiteti i UÇK-së, përveç karakterit çlirimtar të luftës, që në fronte fillon më 1997, ka edhe karakter të identitetit kombëtar, sepse që në Betimin e Ushtrisë, kishte përcaktuar karakterin e saj kombëtar-çlirimtar e të gjitha pjesëve të pushtuara të atdheut dhe bashkimit të tyre me shtetin amë, Shqipërinë. Përkatesisë së këtyre të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nuk mund t'i hiqen as fjalët, as shenjat e pikësimit, ngase nëse do të ndodhte të hiqej diçka, atëherë përkufizimi bëhet i njënjëshëm me qendra të caktuara të Evropës plakë, që e ka quajtur konflikt të brendshëm.

Do të thotë, as konflikt në mes dy grupeve kombëtare, në mes dy

grupeve, që historikisht ishin në armiqësi shekullore, sepse serbi tokat e huaja i kishte marrë dhe i konsideronte të vetat, pa asnjë të drejtë historike, kurse grupi tjetër etnik, shqiptarët pra, me Ushtrinë e tyre çlirimtare, luftonin për ta korrigjuar këtë padrejtësi historike.

Në anën tjetër të këtij përkufizimi, është vënë identiteti i Kosovës, pa ndonjë argumentim të mbështetur në fakte historike, përveç nëse kërkohet që në shekullin XXI të krijohet një komb i ri, ai kosovar, që është kundër historik, që mohon ekzistencën e kombit shqiptar, i cili është formuar në të njëjtin shekull si dhe kombet e tjera të botës moderne.

## Identiteti i Kosovës është vetëm identitet shtetëror

Pse mund të thuhet kështu? Ka disa arsye, të cilat edhe në dijen tonë historike, por edhe në trajtesa të veçanta, as nuk përmendet sa duhet, as nuk përkufizohet drejtë. Arsyet janë të shumta, por disa janë vendimtare, që do të preken këtu, pa u lodhur shumë, radhitën sipas meritës së vlerës, apo pa pasur ngarkesë se i bien dikujt tamam, apo nuk i bien.

Së pari, Kosovën e kanë njohur shtet kryesore të botës, fuqitë më të mëdha, ato që ishin bërë krahë i Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Por, ato shtete ishin bërë krahë i luftës, kur Kosova nuk ishte ende shtet.

Së dyti, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë kishte dhënë përgjigje pozitive në kërkesën e Serbisë, se Kosova nuk mund të bëhej shtet, së paku pa e pyetur Serbinë.

Së treti, Kosova ka mbajtur disa palë zgjedhje të lira, edhe sipas vlerësimit të qendrave evropiane, në të cilat janë përfshirë edhe komunitetet pakicë me të drejta më të mëdha se kudo në Evropë, ngase Kosova nuk guxonte të bashkohej me asnjë shtet fqinj, thujse ajo do të bashkohej me dreqin e të birin, e jo me shtetin amë, Shqipërinë.

Së katërti, qoftë edhe vetëm ky përkufizim, se nuk ka të drejtë të bashkohet me asnjë vend fqinj, dëshmon për dy rrafsh të ndryshme identitetesh. Për rrafshin e parë të identitetit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si bartëse e idealit kombëtar, që historikisht ka hapur procesin e madh historik të bashkimit kombëtar, i cili një ditë, doemos do të realizohet, qoftë edhe vetëm

për hir të padrejtësive historike që i janë bërë popullit shqiptar. Për rrafshin e dytë të identitetit të Kosovës, së cilës nuk i njihet identiteti i saj kombëtar, por aq më keq, nuk ka të drejtë të bashkohet me shtetin amë, Shqipërinë.

Kush mund ta shpjegojë këtë logjikë të qendrave evropiane të vendosjes, mund të ketë rastin të bëhet njohësi më i mirë i përpjekjeve të Evropës në procesin e Bashkimit Evropian.

## Përfundim

Ushtria e dalë nga populli, promovoi rregulla e norma etike të sjelljes, gatishmëri për të bërë sakrificën sublime për kombin e për tokën arbërore andaj ishte bërthama e bërjes së lirisë. Në përkufizimet e deritashme del se identiteti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është çlirimi i pjesëve të pushtuara të atdheut tonë, Shqipërisë.

Kosova nuk mund të përkufizohet si atdhe i shqiptarëve, sepse kështu kanë vendosur fuqitë e mëdha, sepse ndryshe do të kërkohej bashkimi kombëtar, gjë që e pengonte, siç e pengon edhe sot e nesër, sidomos Evropën, me atë politikën e saj të kriterëve të dyfishta.

Më tutje, udhëheqës të shqiptarëve, në këto 20 vjet pas Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si dhe pas Luftës së UÇPMB dhe të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, sa herë në fushata zgjedhore kanë përmendur bashkimin kombëtar, të nesërmen janë tërhequr nga deklarimet e tyre, qoftë nën trysinë evropiane, qoftë nga mendësia e tyre fisnore, sepse u mjaftonin gjysmat e pjesët që u kishin lënë të tjerët. Sido që të jetë bashkimi kombëtar nuk bëhet me deklarata as me fjalë, por bëhet me veprim konkret, që duhet të fillojë nga unifikimi i kutikulave shkollorë për të vazhduar tutje.

Prandaj, argumentohet se politika që zhvillohet në jetën e shqiptarëve, nuk është politikë e bashkimit kombëtar. Kurse lufta që ka bërë Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ka hapur procesin e madh historik të bashkimit kombëtar. Nëse realizohet ky projekt, që një ditë do të realizohet doemos, atëherë mund të flitet edhe për identitetin e këtyre dy rrafshëve, të Kosovës dhe të UÇK-së, si rrjedhojë normale e proceseve historike, në të cilët janë korrigjuar padrejtësitë historike të shkaktuara, edhe nga faktori i brendshëm, edhe nga ai ndërkombëtar.



# BQK-ja rishikon tarifatat e sigurimit për vetura

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka refuzuar kërkesat e kompanive të sigurimit për rritje të çmimit të policave të sigurimit për 36,5 për qind. BQK-ja ka njoftuar se duke vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe duke u bazuar edhe në Raportin Vlerësues të Rishikimit të Stabilitetit të Sektorit Financiar 2019 të kryer nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, ka filluar procesin e rishikimit dhe vlerësimit të primit të rezikut për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia.

"Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), sipas legjislacionit në fuqi, është institucion i pavarur dhe përgjegjës për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare në Republikën e Kosovës. Një ndër objektivat kryesore të saj është që të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, i cili ofron sigurinë e nevojshme për të gjithë shfrytëzuesit e shërbimeve financiare", është thënë në komunikatën e BQK-së, duke u shtuar se në këtë kuadër, një ndër fushat kryesore të përgjegjësisë së BQK-së ka të bëjë me sektorin e sigurimeve ku BQK-ja në vazhdimësi angazhohet për mbrojtjen e interesave të policëmbajtësve, duke siguruar kushtet e nevojshme që të dëmtoarit të trajtohen në përputhje me kushtet e përcaktuara me kontratën e sigurimit. "Për këtë qëllim, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, duke vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe duke u bazuar edhe në Raportin Vlerësues të Rishikimit të Stabilitetit të Sektorit Financiar 2019 të kryer nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, ka filluar procesin e rishikimit dhe vlerësimit të primit të rezikut për sigurimin e detyrueshëm nga

autopërgjegjësia. Çmimet aktuale të primeve për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palës së tretë kanë mbetur të pandryshuara që nga viti 2001. Në këtë periudhë të gjatë që nga koha kur ato janë përcaktuar, në tregun ku operojnë kompanitë e sigurimeve kanë ndodhur zhvillime të shumta, të cilat në mënyra të ndryshme kanë pasur ndikim mbi kompanitë e sigurimeve si dhe policëmbajtësve dhe e kanë bërë të domosdoshëm inicimin e rishikimit të këtyre çmimeve në mënyrë që ato të reflektojnë në mënyrë më adekuate kushtet e tregut", është thënë në këtë komunikatë të BQK-së.

Sipas BQK-së, në kuadër të faktorëve kryesorë që kanë ndikuar kushtet e tregut gjatë kësaj periudhe, përfshihen: Rritja e numrit të dëmeve dhe rritja e vlerës së pagesës së dëmeve, posaçërisht të automjeteve të kategorisë I; Rritja e shumës së detyrueshme minimale të sigurimit për kontraktimin e sigurimit të autopërgjegjësive me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia në vitin 2011; Efekti i aplikimit të sistemit Bonus-Malus në zbatim që nga viti 2013 dhe që sipas llogaritjeve dhe trendit rënës të të ardhurave të siguruesve për efekt të Bonus Malusit. "Sipas kalkulimeve të bëra, është projektuar që në fund të vitit 2019 këto të ardhura të zbriten për rreth 19 për qind dhe se 93-94 për qind të policëmbajtësve nuk shkaktojnë aksident, prandaj edhe përfitojnë bonus që shkakton edhe të ardhura më të ulëta për siguruesit. Veçanërisht shkalla e inflacionit, e cila ka ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen dhe mbulimin e kostos së dëmeve, si për nga çmimet e riparimit të dëmet materiale, por edhe si pagë me rastin e kompensimit të fitimit të humbur apo



mbajtjes së humbur të dëmet jomateriale si pasojë e rritjes së pagës mesatare", është bërë me dije në komunikatën BQK-së, duke shtuar se si rezultat i zhvillimeve të lartcekura është ndërmarrë studimi aktuarial, i cili ka sugjeruar për rritje të tarifave të 'Kategorisë I' (automjete me pasagjerë) për 36.56 për qind. "Megjithatë, BQK-ja në vlerësimin e saj ka identifikuar disa faktorë të cilët nuk janë reflektuar plotësisht në raportin aktuarial, prandaj edhe ka refuzuar kërkesën e kompanive të sigurimit për ndryshim të tarifave duke u bazuar në atë raport", thuhet në komunikatë. BQK-ja ka vlerësuar se kompanive të sigurimit duhet t'u mundësohet përshtatja e tarifave të 'Kategorisë I' për shkallën e inflacionit të ndodhur gjatë periudhës 2002-2018 në mënyrë që këto tarifa të sigurimit të reflektojnë sa më mirë kushtet aktuale të ekonomisë. "Përshtatja e tarifave për kushtet e inflacionit ka ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin e qëndrueshmërisë së këtij sektori, duke rritur kështu aftësinë e kompanive të sigurimit për kompensim të drejtë dhe me

kohë të dëmeve për policëmbajtësit. Prandaj, me qëllim që tarifatat e sigurimit të reflektojnë më mirë zhvillimet në ekonominë e vendit dhe në këtë mënyrë të krijojnë kushtet për rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit të sigurimeve, si dhe përmbushjes së rekomandimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për rishikim të tyre, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2019, bazuar në nenin 36, paragrafin 1, nënparagrafin 1.17 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 8, paragrafi 5 të Ligjit nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, si dhe nenin 5, paragrafin 2, nenin 7, paragrafin 7 të Rregullores për përcaktimin e strukturës së primit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, ka marrë vendim për ndryshimin e tarifave të primit të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia për kategorinë e mjeteve për pasagjerë (grupi tarifor I)", thuhet në komunikatën e BQK-së. Sipas këtij vendimi, BQK-ja ka

kërkuar nga siguruesit që t'i përshtatin tarifatat aktuale të primit të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia për grupin tarifor I, të cilat janë në fuqi që nga data 1 korrik 2001, me normën e inflacionit zyrtar të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës të datës 01. 01. 2002 deri më 31. 12. 2018. "Përshtatja e tarifës së primeve përkatëse me inflacion duhet të bëhet duke zbritur normën e tatimit në qarkullim prej 5 përqindësh e cila ka qenë në fuqi deri më 25 korrik 2019 me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 06/L -105 për tatimin në të ardhurat e korporatave, ku siguruesit u nënshtrohen tatimit në fitim. BQK-ja do ta shtojë angazhimin e saj me qëllim që sektori i sigurimeve të jetë në zbatim të plotë të legjislacionit dhe rregullativës në fuqi. Në këtë drejtim, në periudhën në vazhdim BQK-ja do t'i kushtojë vëmendje të veçantë zbatimit të kërkesave ligjore dhe rregullative. Moszbatimi i kërkesave të tilla nga siguruesit do të përcillet me masa adekuate administrative, duke mos përjashtuar edhe revokimin e licencave për kompanitë të cilat nuk zbatojnë legjislacionin në fjalë", është theksuar në komunikatën e BQK-së.

# ATK-ja konfiskon pasuri të borxhlinjve në vlerë mbi 183 mijë euro

PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka bërë me dije se ka zhvilluar një aksion për konfiskimin e pasurisë së tatimpaguesve të cilët nuk kanë përmbushur kërkesat ligjore të ATK-së në pagesën e borxheve në afatën e përcaktuar. Procedura e konfiskimit, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, është zhvilluar ndaj tetë tatimpaguesve sipas planit paraprak, ndërsa vlera e mallrave dhe pasurisë së konfiskuar është 183 778 39 euro. "Si rezultat i shumë aktiviteteve intensive që administrata tati-



more është duke ndërmarrë, kemi trend pozitiv të zvogëlimit të borxheve, të cilat kanë reflektuar në rritjen e të hyrave. Që nga fillimi i këtij viti e deri më tani ATK-ja ka mbledhur gjithsejtë 83.6 milionë euro borxhe, që në krahasim me vitin e kaluar kemi zvogëluar borxhin për 21 milionë euro. ATK-ja do ta vazhdojë mbledhjen e të gjitha borxheve të papaguara, duke ua ofruar tatimpaguesve mundësinë e lidhjes së marrëveshjeve për pagesë të borxheve sipas procedurave të parapara ligjore", është thënë në njoftimin e ATK-së.

Sipas këtij njoftimi, në të njëjtën kohë ndaj të gjithë tatimpaguesve borxhlinj, të cilët neglizhojnë pagesën e borxheve të tyre, ATK-ja do ta aplikojë mbledhjen e detyrueshme për inkasimin e këtyre borxheve, që nënkupton konfiskimin e pasurisë dhe format e tjera detyruese të parapara me ligj. "Përveç konfiskimit të pasurisë, ATK-ja bën me dije se aksioni në fjalë do të shtrihet edhe në mbledhjen e të gjitha gjobave mandatore të cilat janë të papaguara", është thënë në këtë njoftim.

# RAPORTI I INSTITUTIT ZVICERAN PËR R

Gazeta "Epoka e re" në vazhdimë do t'i botojë dy raportet e përkthyer në gjuhën shqipe, njërin prej 44 faqesh dhe tjetrin prej 15 faqesh, të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës, për rastin e Astrit Deharit. Këto dy raporte tashmë i ka Prokuroria Themelore në Prizren, familja e Astrit Deharit dhe avokati Tomë Gashi. Raporti publikohet pa asnjë ndërhyrje.

## V. PËRFUNDIMET

Në vazhdim të rishikimit të hetimeve të policisë, mjekëve-ligjorë dhe mjekëve-psiko-socialë që e rrethojnë z. DEHARI Astrit, ne mund të nxjerrim konkludimet në vazhdim:

- Vdekja e z. DEHARI Astrit është rezultat i asfiksionit, sigurisht me ngulfatje të llojit *Smothering*.
- Objekti i gjetur në gojë (shishja me mjalte) ka mundur të përdoret për të mbyllur rrugët ajrore të z. DEHARI Astrit.
- Plagët sipërfaqësore, të vërejtura në nivelin e regjionit latero-cervical të djathtë dhe të kycit të majtë, janë pasoja të traumave të provokuara nga një objekt i mprehtë dhe, sipas lokalizimit, tregojnë së pari lëndime të vetë-kryera. Nga fakti i karakterit të tyre sipërfaqësore dhe se z. DEHARI Astrit kishte njohuri mjekësore, këto lëndime me vështirësi janë shkaktuar nga autori me qëllim që të shkaktojë vdekjen. Hipoteza se lëndimet janë shkaktuar nga një person i tretë me qëllim të maskimit të krimit duhet të evokohet dhe përjashtohet.
- Disa lëndime të konstatuara mbi trupin e z. DEHARI Astrit nuk janë përshkruar nga mjekët ligjorë të cilët e kanë kryer autopsinë dhe të tjerat nuk janë marrë parasysh në konkluzionet përfundimtare të raportit të autopsisë:
  - Lëndimet me shtypje janë gjetur në nivelin e pjesës laterale të djathtë të fytyrës dhe të pjesës laterale të djathtë të qafës. Nga lokalizimi i tyre, origjina aksidentale e këtyre lëndimeve duket pak e mundshme. Një mekanizëm sikurse kompresioni cervical manual do të jetë ndoshta shkak i tij.
  - Lëndimet me shtypje janë gjetur në nivelin e parakrahut të djathtë. Edhe pse jo specifike, këto mund të jenë shkaktuar nga mbërthimi i krahut, por pa pasur mundësi ne të përjashtojmë ndonjë shkak tjetër.
  - Duke pasur parasysh se çka paraprind, shumë lëndime të pranishme mbi trupin e z. DEHARI Astrit nuk janë shpjeguar në mënyrë bindëse (transporti i trupit, procesi i rianimit mjekësor "konvulsionet" që shoqërojnë obstruksionin e rrugëve ajrore), por mund të interpretohen si lëndime që evokojnë intervenimin e një personi të tretë (lëndimet me shtypje në nivelin e pjesës inferiore të djathtë të fytyrës, të pjesës laterale të djathtë të qafës, të parakrahut të djathtë dhe të dorës së djathtë).
- Si përfundim, hipoteza e vetëvrasjes së z. DEHARI Astrit me mjetet e paraqitura nga mjekët ligjorë nuk duket e vërtetë. Për këtë arsye rrethanat e vdekjes së z. DEHARI Astrit janë, sipas mendimit tonë, të përfshira me një dyshim të intervenimit të personit të tretë në procesin fatal. Ekzaminimet plotësuese janë të nevojshme për të përjashtuar intervenimin e personit të tretë në vdekjen e z. DEHARI Astrit.

## VII VËREJTJE DHE PROPOZIME:

Më 25 maj 2019, ne kemi pranuar materialin që ka të bëjë me këtë çështje, i cili është transferuar në Njësinë tonë të Gjenetikës Forensike. Analiza e këtij materiali do të mund të jepte më shumë elemente për të ndriçuar rrethanat e vdekjes së z. DEHARI Astrit. Për këtë fakt, një raport që ka të bëjë me analizën e këtij materiali ju do t'ju mbërrij më vonë në formë të një ekspertize plotësuese.

Ne jemi në dispozicion tuajin për ndonjë analizë toksikologjike plotësuese.

(nënshkrimi i palexueshëm)

14.06.19

**Dr. D AGUIAR**

Mjekësi interne

(nënshkrimi i palexueshëm)

20.06.19

**Prof. Dre med. S. GRABHERR**

Specialist FHM në mjekësi ligjore

Drejtoreshë e CURML

(nënshkrimi i palexueshëm)

17.06.19

**Prof Dr med. T. FRACASSO**

Specialist FHM në mjekësi ligjore

Mjek-shf

Përkthimi i certifikuar nga gjuha frënge

Qendra universitare Ramnd e mjekësisë ligjore  
Njësia romande e mjekësisë feronzike  
Chemin de la Vulliette 4, CH-100 Lausanne 25

Prof. Dr. mej. Tony Fracasso  
Mjek shf, përgjegjës

Dre mjek Claudia Castiglioni  
Mjke ndihmëse, përgjegjëse për faqen e Lausanne

Tel.: 021 314 70 70

[www.curml.ch](http://www.curml.ch)

Lausanne, më 9 shtator 2019

N/ref. EI190001 SG/TF/VIC – ekspertizë plotësuese e EI180001  
V/ref: PPN / I nr. 461/16

Më 5 shkurt 2018, ne kemi pranuar nga z. Metush Biraj, Prokuror kombëtar i Republikës së Kosovës, një urdhër në kuadër të një kërkesë të ndihmës së ndërsjellë ndërkombëtare që lidhet me vdekjen e :

**Z. DEHARI Astrit**  
I lindur më 26 shkurt 1990  
I mbajtur në qendrën e paraburgimit në Prizren (Kosovë)  
Vdekja konstatohet më 05 nëntor 2016 në 15:55

Më 25 maj 2019, ne kemi pranuar një pako që përmbante objektet që u morën në konsideratë për analizën e ADN. Kjo shtesë e tanishme e ekspertizës merret vetëm me analizën e ADN-së.

Më 14 qershor, ne kemi bërë një raport të parë (ekspertizë EI18001), i nënshkruar nga Profesorët Fracasso dhe S. Grabherr dhe Dr. D. Aguiar. Ky raport bazohet mbi dosjen e transferuar në procedurë e cila na është përcjellë sipas mandatit tonë. Ajo bazohet në veçanti në mbi analizat e reja dhe interpretimet e videove, fotografive dhe dispozitivet histologjike të autopsisë të z. DEHARI, si dhe albumi i fotografive e vendit të gjetjes së trupit.

Qëllimi i kësaj ekspertize të re është integrimi i analizave gjenetike në konkluzionet tona mjeko-ligjore. Ne jemi përgjigjur në kërkesën tuaj. Ju do ta gjeni më pastaj ekspertizën tonë e cila bazohet në :

- Raportin e analizës ADN 19-T03497 që ka të bëjë me ri-analizën e disa mostrave që përmban dosja e pranuar më 25 maj 2019
- Raportin e ekspertizës EI 180001.

## I. PËRKUJTIMI I FAKTEVE

Më 5 nëntor 2016, pak pas orës 15:00, z. DEHARI Astrit është gjetur i pajetë në qelinë A3 të qendrës së paraburgimit në Prizren në Kosovë, ku ishte mbajtur për terrorizëm dhe posedim ilegal të armës. I transportuar në spitalin rajonal të Prizrenit, u konstatua vdekja e tij në 15:15 të njëjtën ditë.

Trupi i pajetë i z. DEHARI Astrit është gjetur nga tre të mbajtur të tij, pas kthimit nga shëtitja në të cilën z. DEHARI Astrit nuk ishte dalë sepse ai ndjehej keq. Në momentin e gjetjes së trupit të z. DEHARI Astrit i shtrirë në shpinë mbi dysheme, me një shishe mjalte prej plastike në gojë. Një autopsi mjeko-ligjore është kryer mbi trupin e pajetë të z. DEHARI Astrit në Institutin e Mjekësisë Ligjore të Kosovës. Raporti i autopsisë konkludoi një asfiksi mekanike nga pengesat e rrugëve të frymëkampiones me një objekt i qëndrueshmërisë së ngurtë dhe me një ndalesa refleksi të aktivitetit kardiak. Për ndryshe, lëndimet në nivelin e qafës dhe të kycit të dorës së majtë janë përshkruar si të vetë-shkaktuara. Në përfundim të hetimit, është konkluduar se z. DEHARI Astrit kishte bërë vetëvrasje duke u asfiksuar me një shishe plastike. Familja e të mbajturit, duke pasur dyshime në hetimin preliminar, kanë kërkuar që ekspertë mjeko-ligjorë të zgjedhur nga ata të jenë të pranishëm gjatë autopsisë. Sipas mendimit të tyre, vdekja e z. DEHARI është pasojë e një asfiksioni mekanik traumatik i shkaktuar nga një obstruksion i rrugëve ajrore interne, i nxitur nga një shtypje e madhe e një objekti me përbërje të fortë.

## II: ANALIZA GJENETIKE

Cf raportin 19-T03497-vic.

# ASTIN E VDEKJES SË ASTRIT DEHARIT

Përkthimi i certifikuar nga gjuha frënge

Qendra universitare Ramond e mjekësisë ligjore  
Njësia romande e mjekësisë forenzike  
Chemin de la Vuilliet 4, CH-100 Lausanne 25 f. 1/11

Njësia e gjenetikës mjekoligjore

Vincent Castella, Dr es Sc.  
Përgjegjës

Tel : +41 21 314 70 70  
www.curml.ch

Merita Gashi  
Këshilltare e Kryeprokurorit të Shtetit  
Republika e Kosovës  
rr. Luan Haradinaj  
Prokurori i shtetit Kati 1 Zyra 104  
Prishtinë  
Kosovë

Lausanne më 12 gusht 2019

N/ref : 19-T03497 – vic  
V/ ref. PPN / I nr. 461/16  
Ref. URMF : EI180001

Raporti i analizës së ADN-së

Zonja, Zotërinj

Ne kemi pranuar nga z. Metush Biraj, Prokuror kombëtar i Republikës së Kosovës, një dosje të datës 5 shkurt 2018, në kuadër të një kërkesë të ndihmës ndërkombëtare. Kjo dosje i drejtohet Qendrës Universitare Romande e Mjekësisë Ligjore me kërkesën që të ndërmerren të gjitha hulumtimet e pavarura të nevojshme për të hedhur dritë mbi vdekjen e :

Z. DEHARI Astrit  
I lindur më 26 shkurt 1990  
I mbajtur në qendrën e paraburgimit në Prizren (Kosovë)  
Vdekja konstatohet më 05 nëntor 2016 në 15:55

Më 25 maj 2019, morëm një pako që përmbante objektet që përmbante objektet që u morën në konsideratë për analizën e ADN. Kjo shtesë e tanishme e ekspertizës merret vetëm me analizën e ADN-së. Ajo është e bazuar në :

- Një përkthim të raportit të ekspertizës gjenetike të "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" të 18 nëntorit 2016 të titulluar raport i ekspertizës për prokurorin e përgjithshëm AFK/2016-3193/2016-2859.

Nr. labo : 19-T03497

- Një përkthim të raportit të ekspertizës gjenetike të "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" të 25 nëntorit 2016 të titulluar Raport i ekspertizës për prokurorin e përgjithshëm AFK/2016-3193/2016-2905.
- Një DVD me mbishkrimin "ELEKTROFERROGRAMET . ASTRIT DEHARI" që përmban profile të ADN,
- Raportin EL180001 të CURML të 14 qershorit 2019,
- Ri-analizën e disa mostrave që përmbushin pakon e pranuar me 25 maj 2019

Ekspertiza jonë është e përbërë nga :

- Analizat e ADN-së të "Agjencisë Kosovare të Forenzikës"**
  - Përkthim të raportit AFK/2016-3193/2016-2859
  - Përkthim të raportit AFK/2016-3193/2016-2905.
  - Vërejtjet sa u përket analizave të ADN-së të "Agjencisë Kosovare të Forenzikës"
- Analiza të reja të ADN-së**
  - Metodat
  - Materiale dhe rezultatet
  - Vërejtjet dhe interpretimet
- Bilanci i analizave të ADN-së dhe konkluzionet**
  - Analizat e realizuara nga "Agjencisë Kosovare të Forenzikës"
  - Analizat e realizuara nga CURML
  - Konkluzionet
- Bibliografia**

Raporti aktual është i vlefshëm vetëm për mostrat e analizuar dhe në kufizimet e ndjeshmërisë së metodave të përdorura. Ky raport nuk mund të riprodhohet, përveç në integritetin e tij, pa autorizimin me shkrim të laboratorit. Sipas Urdhërësës për profilet e ADN-së (RS 363.1, neni 6 al. 2), e gjithë ose një pjesë e gjurmëve që nuk përdoren për analiza i kthehen autoritetit kërkues. Laboratori ruan gjatë pesëmbëdhjetë viteve ADN-në ekstrakte nga gjurmët të cilat nuk janë përdorur gjatë analizës. Pas kësaj periudhe dhe pa kërkesë të ruajtjes të mëtejshme të lëshuar nga autoriteti kompetent, ADN-ja asgjësohet.  
Nr. labo : 19-T03497

1. Analizat e ADN-së të "Agjencisë Kosovare të Forenzikës"

1.1. Përkthimi i raportit AFK/2016-3193/2016-2859

Sipas raportit, rezultatet pozitive në testin paraprak për praninë e gjakut janë marrë për mostrat #3, #4, #4.1, #5, #6, #7, #9, #10, #11, #13, #14, #15, #17 dhe të rezultateve negative për mostrat #1, #2, #8, #12, #16, #18, #21.

Profilet e ADN-së të përputhshme me atë të z. DEHARI (#A.D) janë theksuar për mostrat e mëtejshme : një shtupë (#3), një peshqir i gjelbër (#4), një peshqir gri-jeshile (#4.1), një shishe prej plastike (#5) një çajnik (ibrik) i markës "SINBO" (#6), një sapun ngjyrë trëndafili i markës "PALMOLIVE" (#7), dy shtupa (#9), një shtupë (#11), një shpuzë e mbështjellë me këmbë (#12), një ambalazhe prej plastike me mbishkrim "Gillette-MACH3" dhe një brisk rroje i përdorur (#13), një stilolaps me mbishkrim "ECOLAB" (#14), një tapë (#15), mbeten thonj të dorës së djathtë të Astrit DEHARIT (#D.D) dhe mbesin edhe thonj të dorës së majtë të Astrit DEHARIT (#D.M).

Ky raport tregon se analizat e ADN-së nuk janë realizuar mbi mostrat:

- E një shtupe (#10), një copë e hollë (#17), e një ore të markës "MOWATCH" (#19) dhe e një qeseje të zezë e lidhur (#21) të cilat nuk përmbanin sasi të mëdha të ADN-së për të bërë analizë,
- E një dantelle<sup>1</sup> të kaltër (#1) dhe dy pjesëve të najlonit të zeza të pëshjtjellë (#8) të cilat nuk përmbanin sasi të mëdha të ADN-së për të bërë analizë,
- E një leckë të përhintë (#2) dhe e një shtupe (#16) të cilat nuk përmbanin sasi të mëdha të ADN-së për të bërë analizë,

Vërejtje: vetëm profilet e ADN-së të papërziera dhe të përputhshme me profilin e ADN-së së z. DEHARIT janë vëzhguar. Asnjë ADN tjetër nuk është vëzhguar.

1.2. Përkthimi i raportit AFK/2016-3193/2016-2905.

Sipas këtij raporti, rezultatet pozitive në testin paraprak për praninë e gjakut janë mbajtur për mostrat #A1, #A2, #A3, #A4, dhe një rezultat negativ për mostrën #A5.

Profilet e ADN-së të përputhshme me atë të z. DEHARI janë vënë në pah për mostrat e mëtejshme: një palë pantallona sportive me mbishkrimin "S / SPRINT" (#A1), një "marcele" e bardhë me mbishkrimin "SEDEF" (#A4).

Ky raport tregon se analizat e ADN-së nuk janë realizuar mbi mostrat:

- Një xhemperi i zi (#A2) i cili nuk përmbanin sasi të mëdha të ADN-së për të bërë analizë,
- Një palë çorapë (#A5) të cilat nuk përmbanin ADN njerëzore.

Vërejtje: vetëm profilet e ADN-së të papërziera dhe të përputhshme me profilin e ADN-së së z. DEHARIT janë vëzhguar. Asnjë ADN tjetër nuk është vëzhguar.

<sup>1</sup> Lidhëse këpucësh

1.3 Vërejtjet që kanë të bëjnë me analizat e ADN-së të "Agjencisë Kosovare të Forenzikës"

- Gjurmueshmëria e mostrave/kampioneve

Pakja që përmbante mostrat është hapur më 26.06.19 në prani të një përkthyesjeje zonj. Sanije SOPA, që punonte për Shërbimi i Apartamenteve. Kështu na është mundësuar të verifikojmë se ambalazhi i të gjitha mostrave të listohet në të dy raportet paraprakë të cituara ishin të pranishëm.

Sipas të kuptuarit tonë, numrat në tërësi ose shkronjat që shoqërojnë numrin në tërësi u janë atribuar mostrave, për shembull #4 : një peshqir i gjelbër, #6 një çajnik i markës "SINBO", #14: një stilolaps me mbishkrim "ECOLAB", "A1 : një palë pantallona sportive me mbishkrim "S / SPRINT" #A3 : një "marcele" e bardhë. Këto shënime të përcjella nga një pikë dhe nga një shifër që tregojnë kampionet të cilat janë realizuar mbi mostrat për të cilat bëhet fjalë. Për shembull, #6.1 :2 shtupa në dorezën e çajnikut #6.

Mostrat e raportit AFK/2016-3193/2016-2859 janë shifruar nga #1 deri në #21 si dhe "D.D, #D.M, #A.D. nuk ekziston numri 20 në këtë listë, pa u cekur arsyet.

Në mënyrë të përgjithshme, është e vështirë të bëhet lidhja ndërmjet listës së mostrave që figurojnë në raporte, elektroferogramet (EPG) të regjistruara mbi DVD dhe rezultatet e raportuara nga "Agjencisë Kosovare të Forenzikës".

Sipas raportit AFK/2016-3193/2016-2859, për mostrat #4, të EPG janë në dispozicion për #4.1, #4.1.A dhe #A.2 pa u përcaktuar vendi i marrjeve. Përshkrimi i vendit të marrjeve mungon për kampionet #6.2, #12.1, #13.1, #13.2 dhe #14.4. disa nga kampionet janë konsideruar si mostra. Për shembull #3: një shtupë. Nuk ka indikacione sa i përket vendit ku ky kampion është realizuar. Një situatë e ngjashme është hasur për mostrat? Kampionet #8, #10, #11, dhe #15. Gjithashtu, për raportin AFK/2016-3193/2016-2905, mostrat #A1, #A2, #A3, #A4, dhe #A5 janë përshkruar, por jo lokalizimi i marrjeve për të cilat EPG janë në dispozicion #A1.1, #A1.2, #A3.2, #A4.1. një fije floku me rrënjën është gjetur me mostrën #A2 (xhemperi i zi). Kjo as nuk është shënuar me numër dhe as nuk është analizuar.

Sipas të dy raporteve, vetëm një rezultat i mostrës është ofruar. Është e pamundur të përcaktohet se çfarë rezultatesh janë marrë për secilën kampion të analizuar. Për shembull, në raportin AFK/2016-3193/2016-2859, për mostrën #14 (një stilolaps me mbishkrim "ECOLAB"), testi tregues i pranisë së gjakut ishte pozitiv dhe një profil i ADN-së i përputhshëm me atë të z. DEHARI Astrit është marrë. Mbi DVD, gjenden EPG për #14.1, dhe #14.4. nuk dihet nëse testi i gjakut ishte pozitiv për të dyja, dhe as çfarë rezultatesh janë fituar për kampionet #14.2 dhe #14.3 (nëse ekzistojnë).

- Mostrat pa analizën e ADN-së

Sipas raporteve, një numër i caktuar i mostrave/kampioneve nuk janë analizuar qoftë për shkak se nuk përmbanin mjaftueshëm ADN, qoftë për shkak se nuk përmbanin ADN njerëzor, qoftë për shkak se nuk përmbanin gjak ose materie tjera biologjike.

**Vijon në numrin e ardhshëm**

Në 30-vjetorin e rënies së Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut (4)

# Rënia e lavdishme e dy heronjve



Shkruan: Mehmet HAJRIZI

1. Periudha historike në të cilën vepruan heronjtë tanë karakterizohet me rrethanat tepër të rënda politike në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare në ish-Jugosllavinë. Veprimtaria e tyre e gjatë dhe e përkushtuar, sa vinte dhe i bënte më të vendosur, më të guximshëm, më të përgatitur dhe me besim të patundur në fitoren e sigurt të luftës së popullit të tyre për liri dhe pavarësi, për çlirim dhe bashkim kombëtar. Ata dinin t'i vlerësonin dhe të orientoheshin në situatat politike ndër më të ndërlikuarat. Detyrat prej militanti dhe drejtuesish organizativë ata i bënin me një përkushtim të rrallë, me guxim e vullnet të hekurit dhe devocion e pasion rinor.

Virtytet e tyre sublime njerëzore e atdhetare, politike e morale, u bëjnë pjesë e rëndësishme e sistemit të vlerave që kultivoi LKSH. Pjesë e rëndësishme e këtyre vlerave të trashëguara nga heronjtë tanë, janë edhe një varg shkrimesh të Afrim Zhitisë, në të cilat trajton çështje të ndryshme të jetës shqiptare nën robëri. Ato janë bërë me kompetencë shkencore dhe politike, të denja për një intelektual të përgatitur mirë për punën profesionale. Afrimi ishte njëkohësisht kontribues i teorisë dhe praktikës revolucionare e çlirimtare.

Siç ka vërejtur autori Adem Gashi, Afrimi në shkrimet e tij dhe letrat nga burgu respekton rigorozisht standardin e shqipes letrare.<sup>1</sup> Në letrat që ai i dërgon familjes nga burgu,<sup>2</sup> për t'iu shmangur censurës, shfrytëzon gjuhën e Ezopit. Për ilustrim të përmendim: mjetet tjera të domosdoshme...që të qëllonin parazitët... (f. 161 e librit, Adem Gashi, a-ZH Vetëtimat e Nëntorit, Prishtinë, 2005), vdekjen e njeriut që i ka kryer detyrat (169), lajmet e radios që parashohin kohën e bukur me diell (f. 171), ëndërrimin e diellit (lirisë), (f.172), marrëveshjen me bomba (173), drutë e malin për çrënjosjen e dimrit (f.173), vitin e ri që sjell forca të reja (173), nervozen e mosbesimit në forcat e veta (f. 175), potencialin e jetës që shtyn drejt qëllimeve të larta (f. 178), arën që e pret krahun (f. 179), lumturinë e lëmoshës (f.180), dëshirën e jashtme armiqësore ndaj dëshirave (idealeve) tona (f. 187) etj., etj. Dielli si metaforë e letrave të Afrimit, i shoqëroi heronjtë tanë deri në Kodrën e Diellit, ku u flijuan për të.

Si veprimtarë të hershëm dhe tashmë me përvojë, ata lidhen breza të LKSH, duke pasuruar përvojën dhe duke i ngritur politikisht e teorisht radhët e saj. Veprimtaria e tyre i lidh dy periudha të lavdishme të rezistencës, asaj 1981 dhe 1989. E para ishte përgatitur nga Lëvizja Kombëtare Shqiptare e viteve '70-të, kurse e dyta gjatë viteve të rimëkëmbjes së saj, pas vitit 1981.

2. Fushata antishqiptare pas kryengritjes së vitit 1981 kishte për

qëllim ta kthente kohën e Rankoviçit në Kosovë, të çrënjoste çdo vatër të rezistencës kundër regjimit dhe të hapte frontin e gjerë të luftës revanshiste kundër shqiptarëve. Por, nuk ishte më koha e Rankoviçit, sepse LKSH-së nuk i duheshin më dhjetë vjet për rimëkëmbje si atëherë, por vetëm dhjetë muaj. Efekti i luftës kundër saj ishte krejt i kundërt; nuk dobësohej po rritje e fuqizojehet akoma më shumë, ngjashëm me rritjen e radhëve të UÇK-së pas rënies së komandantit Adem Jashari dhe familjes së tij në Prekaz. Viti 1989 karakterizohet me një rizgjim kombëtar në Kosovë. Lëvizja, përkrah forcimit të veprimtarisë klandestine, organizoi masat për të demonstruar në rrugë. Po kryheshin edhe vepra sabotimi, por kishte edhe përpjekje të organizimit ushtarak. Në fakt, pas kryengritjes së vitit 1981 në LKSH po ngjizej ideja e fillimit praktik të rezistencës së armatosur.

3. Më 1984 ranë me armë në dorë Rexhep Malaj, Nuhi Berisha e më vonë Bajram Bahtiri. Në luftë me forcat serbe, duke u tërhequr nga një demonstratë më 1989, në fshatin Shtedim ra dëshmor Ali Ajeti. Më 1989 në zonën e Llapit veproi grupi i armatosur që u quajt "Qeta e Llapit" etj. Afrimi dhe Fahri rezistencën e armatosur e shihnin jo vetëm si mundësi teorike në një të ardhme të papërcaktuar, por si diçka shumë praktike për të cilën duhej menduar seriozisht.<sup>3</sup> Këta dhe bashkëveprimtari i tyre i shquar, Fadil Vata ishin paralajmëruesit dhe pararendësit e Ushtrisë Çlirimtare.<sup>4</sup>

Fahri Fazliu e çmonte lart qëndresën e Rexhep Malajt në burg, kurse rezistenca e tij dhe e Nuhiut kundër forcave policore në Kodrën e Trimave, e kishte entuziazmuar shumë, prandaj thoshte: "Nëse më jepet rasti do t'ua krisi ashtu si Rexhepi, Nuhiu e shokë të tjerë. I gjallë nuk bie në duar të armikut."<sup>5</sup>

4. Më 31 tetor dhe 1 e 2 nëntor të vitit 1989, demonstratat në Kosovë kishin aritur përmasa dramatike. Më 1 nëntor vritet Bedri Sokoli, veprimtar syapatrembur dhe militant i përgatitur, kurse shumë të tjerë u plagosën rëndë. Afrim Zhitia mban një fjalim të zjarrt në demonstratë, me të cilin i drejtohej masës prej 12.000 vetave: "Vëllezër dhe motra, jemi tubuar këtu që me forcë ta ngremë zërin kundër pushtuesve shovinistë serbo-maqedonomalalez, të cilët po ushtrojnë dhunë e terror mbi popullin tonë, të cilët vazhdojnë ta mbajnë Kosovën tonë të shtrenjtë të okupuar e në pozitë koloniale."<sup>6</sup>

Më 2 nëntor 1989, në Kodrën e Diellit në Prishtinë, rrethohen nga forcat serbe veprimtarët, organizatorët dhe drejtuesit e LPRK-së, Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, të cilët pas rezistencës plot dhjetë orë kundër qindra forcave kriminale të regjimit, bien heroikisht në altarin e lirisë. Kriminalët vrasës, përveç armëve të zjarrit kundër dy dëshmorëve përdorën edhe helme kimike, kurse pas vrasjes, ua dhanë edhe nga një plumb në ballë.<sup>7</sup>

Rënia e Fahriut dhe Afrimit, vdekja e hershme e Fadil Vatës, shok i ngushtë dhe bashkëluftëtar i tyre,<sup>8</sup> vrasja e Xhemajli Berishës më 1989 etj., ishin goditje tepër e rëndë për LPRK dhe LKSH në përgjithësi, por

Kosova i përballoi sfidat dhe e mbajti kursin e saj drejt fitores përfundimtare.

## Përfundim

Më shumë se vetë sundimi serb në Kosovë, ka zgatur historia e doktrinës serbe kundër shqiptarëve. Ofensiva e shovinizmit serbomadher kundër Kosovës dhe shqiptarëve nën Jugosllavi më 1981 ishte përvijuar shumë më herët, që më 1976 në dokumentin voluminoz, të ashtuquajtur "Libri i Kaltër", sipas të cilit duhej reduktuar ose hequr autonomia e Kosovës dhe e Vojvodinës për të funksionuar në mënyrë unitare Republika e Serbisë.

Sipas kësaj doktrine dhe strategjisë së veprimit antishqiptar, mund të thuhet se Kosovës iu përcaktua dënim me vdekje, por historia u zhvillua sipas ligjeve të dialektikës dhe jo sipas atyre të Serbisë. Se kush do të vdiste, populli shqiptar apo shteti jugosllav, do ta përcaktonte shpejt vitet e fundshekullit XX.

Një shekull përpjekjesh serbomëdha për ta realizuar këtë doktrinë të tërë antishqiptare patën përballë rezistencën njëqindvjeçare të pareshur, të vendosur dhe gjithnjë në rritje të shqiptarëve, deri në ngadhënjimin kundër asaj doktrine. Njëqind vjet luftë, njëqind vjet gjenocid, njëqind vjet represion e sakrificë e kanë dëmtuar rëndë Kosovën, duke mbetur "shtëpia e të varfërve të Evropës", vend i pazhvilluar e i prapambetur, por e kanë robëruar edhe vetë Serbinë, duke i sjellë dëme të parikuperueshme.

Pas gati gjashtëdhjetë vjet përpjekjesh e sakrificash, rëniesh e ngritjesh, LKSH e Kosovës po hynte në dekadën e nëntë të shekullit të kaluar më e përgatitur se kurrë në rezistencën kundër pushtuesit serb e jugosllav.

Ky dhjetëvjetësh fillon me kryengritjen e madhe shqiptare të vitit 1981, e cila shënoi fillimin e fundit të sundimit serb në Kosovë dhe hapi kapitullin e intensifikimit të rezistencës masive shqiptare gjithandej në trevat shqiptare nën Jugosllavi. Si rezultat i këtij intensifikimi të përpjekjeve të hapura e të fshehta dhe i transformimeve radikale në gjithë bllokun e të ashtuquajturit socialist, në kapërcyell të dhjetëvjetëshit vijues Kosova u përfshi në flakët e luftës finale të udhëhequr nga UÇK, e cila rezultoi me dëbimin e forcave serbe dhe ngadhënjimin mbi robërinë gati njëshekullore.

Vitet tetëdhjetë të LKSH të trajtuara në këtë studim shënojnë fitoren më të madhe deri atëherë të rezistencës kundër regjimeve pushtuese serbe e jugosllave në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare nën Jugosllavi, duke kthyer vëmendjen e botës demokratike te çështja e pazgjidhur shqiptare. Përpjekjet titanike të LKSH gjatë viteve tetëdhjetë nga vëzhguesit e huaj shiheshin jo vetëm si një mundësi e çlirim të shqiptarëve, por edhe si një epiqendër e tërmetit të madh e rrënues të Jugosllavisë politike.

Këto dhjetë vjet të rezistencës aktive patën bilanc tragjik të sakrificave të ndërjegjeshme, kur nga radhët e LKSH ranë në altarin e lirisë dhjetëra veprimtarë të shquar dhe drejtues profesionistë dhe qindra dëshmorë të tjerë, për të mos vdekur kurrë. Mijëra të tjerë u vranë ose u plagosën

AFRIM ZHITIA  
1965 - 1989FAHRI FAZLIU  
1963 - 1989

me armë zjari dhe dhjetëra mijë të tjerë u dënuan me burg. Vetëm gjatë kësaj periudhe dhjetëvjeçare në policinë e regjimit pushtues u trajtuan jo më pak se një e treta e popullsisë së gjithmbarshme të Kosovës. Këto janë sakrificat njerëzore, pa llogaritur humbjet dhe dëmet në ekonomi, arsim, shkencë, shëndetësi, kulturë, veprimtarinë botuese, informative, sportive etj. Ky ishte çmimi i lirisë, e cila siç thuhet me të drejtë, rrënjët i ka në gjak. Pas rënies së dy heronjve, dikush mbi varrin e Afrim Zhitisë la një letër pusullë në të cilën shkruante: "Bie një ngrihen njëmijë". Ky ishte efekti i çdo humbjeje të luftëtarëve të lirisë, ky ishte shpjegimi me një fjalë fenomenit të ringjalljes si Feniksi të LKSH dhe vetë dialektika e zhvillimit të saj.

Regjimi pushtues nuk i kishte kuptuar ligjet e zhvillimit të rezistencës së re shqiptare të viteve tetëdhjetë, kur LKSH ishte bërë e paasgjësueshme, por edhe e pandalshme në zhvillimin dhe rritjen e saj.

Akti i fundit dhe logjik i ekspansionit serb që lufta. Për Serbinë ishte luftë për të fituar përjetësisht Kosovën, ose për ta humbur përjetësisht, kurse për shqiptarët për liri a vdekje. Sikur të mos ekzistonte veprimtaria e dendur, konsistente dhe e pareshur e LKSH, qëllimet e Serbisë nuk do të kalonin nëpër gjithë këto faza të mundimshme, por do të arrisheshin shumë herët dhe shumë shpejt. Ky është kuptimi dhe justifikimi i vuajtjeve e sakrificave, i gjakut të derdhur në emër të Kosovës së lirë.

Fahri Fazliu dhe Afrim Zhitia ranë krah për krah, duke iu përgjigjur zjarrit me zjarr. Oshitima e armëve të Nuhi Berishës dhe Rexhep Malajt në Kodrën e Trimave më 1984 dhe e Afrim Zhitisë e Fahri Fazliut më 1989 në Kodrën e Diellit, paralajmëronin vitin e afërt të oshitimës së armëve të UÇK-së në Kosovë.

(Fund)

## Literatura dhe burimet

Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Fjalor Enciklopedik i Kosovës, I, A-K, Prishtinë, 2018, f. 429  
Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Fjalor Enciklopedik i Kosovës, II, L-ZH, Prishtinë, 2018, f. 1815  
Adem Gashi, a-ZH Vetëtimat e Nëntorit, Prishtinë, 2005  
Mehmet Hajrizi, Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Toena Tiranë, 2008  
Dr. Jakup Krasniqi, Lëvizja për Republikën e Kosovës 1981-1991, sipas shtypit shqiptar, Buzuku, Prishtinë, 2011  
Dr. Sabile Keçmezi-Basha, Organizata dhe grupe ilegale në Kosovë 1981-1989, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2003  
Sejdi Gega dhe Fazli Veliu, LPK në vazhden e përpjekjeve për bashkim, themeluese e UÇK, pjesa I, ArbëriaDesign, Tetovë, 2018

Sejdi Gega dhe Fazli Veliu, LPK në vazhden e përpjekjeve për bashkim, themeluese e UÇK, pjesa II, ArbëriaDesign, Tetovë, 2018  
Feriz Hoti, Shqipëria dhe shqiptarët në arkivat dhe shtypin gjerman, Numberg 1996.

Noel Malcom, Kosova një histori e shkurtër, Koha, Botimi i tretë, Prishtinë, 2011.

Veli Llakaj, Tetë vjet në krye të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Tiranë, 2006  
Nezir Myrtaj Homazhe për flijimtarët, Prishtinë, 2015

Nezir Myrtaj, Refleksione, Prishtinë, 2016  
Berat Luzha, Një histori për Sulë Durmishin, Prishtinë, 2006

Kausha Jashari, Do ta vendosim kufirin, Koha, Prishtinë, 2015

Dobrica Qosiq: Kosovo, Novosti, Beograd "Zëri i Kosovës", nr. 12, dhjetor 1989, f.9  
Ramadan Avdiu, I përjetshëm qoftë kujtimi! Fjalë përkujtimi me rastin e gjashtë vjetorit të rënies së Afrim Zhitisë dhe të Fahri Fazliut.

Hajdin Abazi (Lum Haxhiu) Afrim Zhitia, hero i lirisë, "Epoka e Re", më 4 nëntor 2003  
"Zëri i Kosovës", nr. 11, nëntor 1989, f. 10, Ai jetoi krenar, por edhe më krenar ra për lirinë e Kosovës (Fahri Fazliu-Fatmiri) Zëri i Kosovës", nr. 5, mars 1991, Disa fjalë mbi aktivitetin e Fahri Fazliut dhe tri pikëpamjet e tij për çlirimin e Kosovës dhe viseve shqiptare në Jugosllavi

"Zëri i Kosovës", Fahri Fazliu- Fatmiri Ramadan Avdiu, Në 56-vjetorin e heroit Fahri Fazliu, Gazeta Evropa, 24 shkurt 2019  
Teuta Zymberi, Afrim Zhitia biografia, Bota e Re, <http://patriotat.blogspot.com/2015/10/afrim-zhitia-biografia.html>

Teuta Zymberi, 29-vjetori i rënies së dëshmorëve Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, <http://uraebashkuar.com/author/admin/>, 2 nëntor 2018.

Tahir Gjonbalaj, Fjalë në përvjetorin e rënies së dëshmorëve, Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, më 2 nëntor 2011

Nebih Fazliu dhe Tahir Gjonbalaj, shkrim për Fahri Fazliun dhe Afrim Zhitinë Avdiu Bajrami, fjalë përkujtimi për Fahri Fazliun

Fahri Fazliu një kreshnik i shqiptarisë, <https://zeri.info/kultura>  
30. Штга се догађало на Косову, (Çfarë ka ndodhur në Kosovë), Политика, Београд 1981 (Fund)

<sup>1</sup> Adem Gashi, a-ZH Vetëtimat e Nëntorit, Prishtinë, 2005 f. 157.

<sup>2</sup> Letrat e botuara te libri, Adem Gashi, a-ZH Vetëtimat e Nëntorit, Prishtinë, 2005 f.155-188.

<sup>3</sup> <https://zeri.info/kultura/6000/fahri-fazliu-nje-kreshnik-i-shqiptarise/>

<sup>4</sup> Sejdi Gega dhe Fazli Veliu, LPK në vazhden e përpjekjeve për bashkim, themeluese e UÇK, pjesa II, ArbëriaDesign, Tetovë, 2018, f. 5

<sup>5</sup> "Zëri i Kosovës", nr. 5, mars 1991, f. 6

<sup>6</sup> Ramadan Avdiu, I Përjetshëm qoftë kujtimi!, fjalë me rastin e gjashtëvjetorit të rënies së Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut, botuar në librin, Adem Gashi, a-ZH Vetëtimat e Nëntorit, Prishtinë, 2005 f. 248

<sup>7</sup> "Zëri i Kosovës", nr. 11, mars 1991.

<sup>8</sup> Sejdi Gega dhe Fazli Veliu, LPK në vazhden e përpjekjeve për bashkim, themeluese e UÇK, pjesa I, ArbëriaDesign, Tetovë, 2018, f. 168





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



# Alfabeti i atdhedashurisë

## Shkruan: Skender HALITI

Tridhjetë vjet më parë, më 2 nëntor 1989, ranë dëshmorë, në luftë me policinë serbe dhe kolaboratorët e saj shqiptarë, Fahri Fazliu dhe Afrim Zhitia.

Ky nëntor i vitit 1989 ngërthen në vete ngjarje të mëdha që do ta ndryshojnë historinë e botës: bie Muri i Berlinit dhe fillon shembja e rendit të vjetër botëror që kishte ndarë popuj e njerëz, që kishte shkaktuar miliona viktima anembanë botës, por nga ky mur më së shumti vuanin popujt e Evropës së ndarë, në radhë të parë gjermanët dhe shqiptarët, këta të fundit nga një mur i përgjakshëm, ndonjëse i padukshëm që u ngrite menjëherë pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore.

Por rënia e rendit botëror, e dukshme përmes rënies së Murit të Berlinit, për çudi nuk do të kërkojë asnjë jetë njeriu. Një kthesë e madhe historike po kryhej pa vënë në themel të saj gjakun e pafajshëm njerëzor. Euforia do të jetë e madhe, sepse presupozohej që mendja dhe shpirti i njeriut në dyzetë e ca vjetët e jetës në paqe kishte pësuar një transformim të tillë fundamental që, së paku, në Evropë më nuk do ta lejonte përdorimin e dhunës si instrument politik. Disa hulumtues do të shkonin aq larg sa këtë transformim joviolent do ta quanin fillimin e një epoke pa histori. Sipas tyre historia po merrte fund njëherë e përgjithmonë.

Kështu ishte në qendër, por jo edhe në periferi. Atje historia kishte bërë pushim, nuk kishte ecur me hapin e kohës. Jugosllavia që kishte përfituar më së shumti nga ekzistenca e këtij rendi të padrejtë që për disa decaie ishte bërë i perceptueshëm përmes simbolit të saj në Berlinin e ndarë e kishte ndërjetë instinktivisht rrezikun për ekzistencën e saj shtetërore dhe, prandaj, ajo do të mendohej, me të gjitha mjetet që kishte në disponim, të ndryshonte rrjedhën e historisë: me plumba. Një javë të plotë para rënies së Murit të Berlinit në një nga lagjet e Prishtinës, në Breg të Diellit, ajo do të hidhej në aksion për të vrarë ata që përfaqësonin diellin që mungonte, po që e kishte paralajmëruar ditën e re që do të lindte bashkë me të. Një mur i vjetër, pothuajse 100 vjet mes përmes tokave shqiptare, po lëkundej, ndaj dhe ishte momenti i fundit për të bërë diçka në themelet e tij që kërkonin gjakderdhje të re. Ndryshe ai do të shembej shpejt, duke qenë se në Kosovë gjithnjë e më shumë po shtoheshin ata që mendonin e vepronin si protagonistët e një fillimi të ri historik pa të. Fahri Fazliu dhe Afrim Zhitia duheshin ndaluar me çdo kusht. Ata u rrethuan dhe u vranë, sepse nuk u dorëzuan. Ata rezistuan me armë deri në fund.

Nobelisti i sivjetshëm kontrovers, antishqiptari Peter Handke, shkruan në librin e tij "Humbje imazhi" se Evropa e kësaj kohe ishte përfshirë nga një armiqësi e madhe, e vjetër mes popujve. Librat shkollorë qenë ndryshuar, shkruan ai, por, përsëri armiqësia nuk ishte zhdukur që s'ishte zhdukur. Ajo ishte ringjallur edhe më e fortë në këtë moment historik që do të sillte kthesën e madhe. Dhe vërtet ai që mbronte dhe ende mbron me aq ngulm atë Jugosllavi dhe Serbi që shtypte brutalisht shqiptarët që prej një shekulli, të cilëve iu kishte marrë tokën dhe qiellin, Handke në një libër tjetër shqiptarët në Kosovë i quan zogj të qyqes që janë vendosur në çerdhen e huaj serbe në Kosovë, e ndjente intuitivisht se vetëm historitë e falsifikuara dhe librat nuk ishin në gjendje ta ruanin status-quin e dëshiruar. Kishte ardhur koha që të prodhohej histori ndryshe, me gjak, e cila pastaj do të bënte të mundur humbjen e imazheve parake, të dikurshme që kishin precipituar në trurin e miliona njerëzve që e ndjenin veten humbës të mëdhenj. Këtë mesazh joletrar i dërgonin Serbisë qarqe të caktuara në Evropë që s'kishin pushuar kurrë mbështetjen e carëve rusë, pavarësisht ngjyrës së kostumit të tyre politik. Serbia po kalonte momente dramatike gjatë gjithë viteve 1980, duke filluar nga pranvera e hershme e vitit 1981, ndaj dhe këshillave të fshehta të elitave proserbe në Evropë, të cilat pjesërisht i kishte ushqyer për dhjetëvjeçarë të tërë, nuk mund të mos ua vinte veshin. Në shikim të parë, me arsenalin ushtarak dhe potencialin diplomatik që kishte në posedim ajo nuk kishte pse të druhej shumë. Ishte moment crucial historik ku duhej treguar guxim dhe vendosmëri, prandaj ajo vendosi të hidhej në një aksion simbolik. Vrasja e Fahri Fazliut dhe Afrim Zhitisë në Prishtinë shënjon në fakt fundin e një epoke dhe fillimin e një tjetre me luftëra, vrasje masive e gjenocide. Serbia e dinte se po futej në një aventurë të madhe, por ajo që ishte bërë shkak për një luftë botërore, duke e ndjekur me konsekuencë filozofinë e saj politike, duke sikur nuk kishte alternativë tjetër. Këtë filozofi politike raciste antishqiptare e njihnin mirë Fahri Fazliu dhe shoku i tij i idealit Afrim Zhitia. Ata e dinin se Serbia nuk do të hiqte dorë nga plaçka historike që quhej Kosovë, ndaj dhe ishin të vendosur për t'i shkuar deri në fund luftës së tyre që ishte në fakt lufta e shqiptarëve që po vetëdijesheshin se liria e humbur dhe toka e rrëmbyer nuk do të ktheheshin kurrë paqësisht. Ata e dinin se shqiptarët e nëpërkëmbur dhe të përbuzur kishin nevojë për një sjellje të re inkurajuese, për akte qëndrese dhe heroizmi që shkonin deri në vetëflimjimi. Për botën e re që ishte shfaqur në



Në fotografi: Fahri dhe Fadil Fazliu dhe Skender Haliti (autori i shkrimit) në qershor të vitit 1989 në banesën e familjes Fazliu në Bregun e Diellit në Prishtinë.

horizont realiteti duhej të lexohej ndryshe. Për këtë duhej një alfabet tjetër, alfabeti i atdhedashurisë.

Me Fahriun u njoha përmes një miku të përbashkët në Universitetin e Prishtinës. Ishte viti 1986, një vit që në histori ka hyrë si një vit i dënimit masiv nëpër gjykatat serbe i rinisë studentore. Gjatë gjithë dekadës '80-të nuk pushuan arrestimet e burgosjet e studentëve të rebeluar, por pas vitit 1981/82 viti 1985/86 përbën vitin me më shumë burgosje e dënime deri atëherë. Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës kishte marrë një goditje të rëndë në këto vite, por ajo ende ekzistonte, vepronte në ilegalitet të thellë. Fahriu gjatë kësaj kohe më furnizonte me libra të ndaluar historie dhe gazeta që nxirrnin qarqet ilegale brenda dhe jashtë vendit. Ata që kishin pushtetin vërtet i kishin ndryshuar librat shkollorë, për të cilët flet nobelisti i dezignuar Peter Handke, por ato s'i besonte kush. Në kishim librat tanë, ata të tyret që vazhdonin të gënjenin e mashtronin, atë mashtrim që sot ende e vazhdojnë përkrasit e hapur apo të fshehtë të Millosheviqit. Gjithë ato masakra dhe vrasje të llojllojshme që kreu anë e mbanë Jugosllavisë kasapi i Ballkanit në fakt fillin e kanë në Kosovë dhe pikërisht me 2 nëntor 1989. Vrasja e patriotëve Fahri Fazliu dhe Afrim Zhitia është vrasja e parë në Jugosllavi që do të kryenin strukturat shtetërore që komandoheshin nga Slllobodan Millosheviqi, aparat shtetëror ky që do të fillojë shumë luftëra, njëherë pas tjetrën, në hapësirën jugosllave kundër popujve joserbë.

Politika serbe për shumë kohë shtypjen e shqiptarëve e kishte realizuar në rrethanat e një koniunkturë të përshtatshme ndërkombëtare duke shfrytëzuar resurset e federatës jugosllave, mirëpo kësaj politike me kalimin e kohës po ishtoheshin kundërshtarët te të gjithë popujt e federatës, sepse po bëhej gjithnjë e më e qartë se synimi i Beogradit ishte një Jugosllavi centraliste që merr para sysh vetëm interesat e serbëve dhe shpërfill ato të kombeve të tjera.

Fahri Fazliu formimin e tij atdhetar nuk mund ta merrte nga

librat për të cilët flet Peter Handke, sepse në to Kosova quhej tokë serbe, zemra e Serbisë, por nga libri i jetës. Nga rrëfimet e të rriturve dhe të moshuarve, ishte vënë në kontakt me një të vërtetë tjetër tronditëse, me të vërtetën e pushtimit të përgjakshëm të Kosovës dhe tokave të tjera shqiptare nga fqinjët tanë që në luftërat ballkanike. Ai e dinte se harta e Ballkanit ishte bërë diku larg në Evropë dhe kështu shqiptarët ishin martirizuar. Këto imazhe pushtimi, poshtërimit e nënshtrimit ishin të gjalla në kujtesën e kombit dhe, për më tepër, ato ishin vepruese edhe kundër gënjeshtrave të stërholluara të njerëzve me talent letrar e xhelatëve të politikës Millosheviq që në terrenin e historisë bashkëkohore përqipeshin me dhunë e gjak të ndryshonin imazhet e vjetra, duke i zëvendësuar ato me disa më të reja vetëm nga pikëpamja kronologjike, sepse këto imazhe në ishte shumë të vjetra në thelbin e tyre. Fahriu qysh në moshë të re tregoi interesim të madh për zhvillimet politike të kohës së tij. Ai u organizua ilegalisht gjatë kohës sa ishte në shkollë të mesme. Në këtë kohë rinia shkollorë dhe universitare ishte përfshirë në forma të ndryshme të rezistencës dhe të organizimit politik ilegal. Pas përfundimit të shkollës së mesme regjistrohet në Fakultetin e Ndërtimitarisë në Prishtinë dhe njëkohësisht edhe në Shkollë e Lartë të Komunikacionit në Zagreb. Për shkak të gjendjes ekonomike të familjes së tij ishte i detyruar të punonte në hekurudhën e Kosovës në Fushë Kosovë. Gjatë aktiviteti ilegal ai vihet në kontakt me Afrim Zhitinë, i cili kishte një përvojë të madhe organizative si ilegal, përfshirë këtu edhe burgjet jugosllave, nëpër të cilat ai kishte kaluar. Me të u lidh fort, sepse Afrim Zhitia ishte i vendosur për çdo aksion që e kërkonin rrethanat.

Në Prishtinë Fahriu kishte krijuar një bërthamë të fortë veprimtarësh. Ai ishte në krye të Këshillit Popullor të LPRK-së. Në këtë këshill bënte pjesë edhe Afrim, Fadil Vata, etj. Aktiviteti ilegal i Fahriut përfshinte pothuajse gjithë hapësirën shqiptare në ish

Jugosllavi. Kudo ishin formuar Këshilla Popullore. Demonstratat e mëdha të fundit te viteve tetëdhjetave ishin rezultat edhe i punës së Fahriut dhe i shokëve të tij. Rrjeti i shokëve të organizuar të Fahriut ishte i gjerë, ai arrinte deri edhe në Zagreb, ku ai kishte mjaft shokë në mesin e qindra studentëve shqiptarë që studionin atje.

Në prill të vitit 1989 erdhi në Prishtinë një delegacion evropian, i cili u interesua edhe për studentët. Në pritje të këtyre politikanëve nga Evropa do të organizohej një demonstratë në Qendrën Studentore. Kjo proteste ka qenë direkt e organizuar nga Fahriu dhe shokët rreth tij. Fahriu mbante kontakte edhe me Ali Ajetin në Besianë, i cili po ashtu do të bie në përlëshje me policinë disa muaj para Fahriut. Fahriu pati përgatitur një aksion të armatosur për të liruar një shok tonin të torturuar që gjendej në Klinikat Universitare në Prishtinë dhe ruhej nga policia serbe. Bëhej fjalë për Shaban Mujën. Një aspekt tjetër i veprimtarisë së tij është edhe nxjerrja e buletinit informativ "Rruga e lirisë", përmes të cilit do të informohej publiku ndërkombëtar për zhvillimet aktuale në Kosovë dhe për historinë e çështjes shqiptare. Ngjarja si vrasja masive e mijëra luftëtarëve antifashiste në Bari, Konferenca e Bujanit duhet të bëheshin të njohura për një publik të gjerë që ishte i interesuar për rajonin.

Gjatë kohës së grevave të minatorëve, Fahriu bëri shumë në sensibilizimin e studentëve dhe organizimin e tyre në mbështetje të minatorëve. Fahriu ishte shumë i shkathët politikisht, kështu që ai dinte mirë t'i shfrytëzonte te gjitha format e veprimit legal, edhe pse ai ishte i bindur që në kushtet në të cilat vepronin atëherë pa organizim ilegal të mirë ishte shumë e vështirë të arrihej diçka. Në prag të gjyqimit të të 15-ve në Mitrovicë ai organizoi shpërndarjen e një trakti në shumë qytete të Kosovës. Aksionin në Prishtinë dhe në Kastriot e pati udhëhequr vetë Fahriu. Ndërsa unë së bashku me Ekrem Qerimin dhe Xhevat Qerimin i kemi shpërndarë në Ferizaj dhe në Viti.

Shembulli i Rexhep Males dhe i Nuhi Berishës ishte për të një model i veprimit të një atdhetari që është i gatshëm për çdo lloj flijimi. Librin e Rexhep Maljat "Qëndresa" e kishte lexuar dhe rilexuar. Nëse një ditë do të ndodhem në rrethana të ngjashme, më pati thënë disa muaj para rënies së tij, atëherë pa asnjë hezitim do të veproja si Rexhep Malaj e Nuhi Berisha. I gjallë nuk bie në dorën e armikut. Lavdi e përjetshme heronjve të kombit Fahri Fazliu e Afrim Zhitia!

## Uashingtoni vë sanksione të reja kundër Iranit

UASHINGTON, 1 NËNTOR - Qeveria amerikane njoftoi se janë vendosur sanksione të reja që kanë në objektin tregtinë për disa materiale të rëndësishme që përdoren në sektorin e ndërtimit dhe atë ushtarak të Iranit.

Në një deklaratë me shkrim nga sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, theksohet se sanksionet kundrejt Qeverisë së Teheranit do të vijnë duke u shtuar. Në kuadër të sanksioneve është vendosur në objektin

sektori i ndërtimit që, sipas sekretarit Pompeo, ndodhet nën kontrollin ose ndikimin e Gardës Revolucionare të Iranit. Gjithashtu, Mike Pompeo ka njoftuar se në kuadër të sanksioneve është përfshirë edhe

tregtia e katër materialeve të cilat përdoren në programin bërthamor dhe raketave balistike të Iranit. Edhe më parë ShBA-ja kishte vendosur në objektin strukturën financiare të Iranit, e që përfshiu në listën e sank-

sioneve Bankën Qendrore të Iranit. Qeveria e Uashingtonit shtoi në listën e sanksioneve edhe liderin iranian Ayatollah Ali Khamenei, ministrin e Jashtëm, Javad Zarif, dhe Ushtrinë e Gardës Revolucionare të Iranit.

# Britania mbron marrëveshjen për Brexitin pas kritikave të Trumpit

Pasi Trumpi tha se ShBA-ja nuk mund të nënshkruajë marrëveshje me Mbretërinë e Bashkuar pas marrëveshjes për Brexitin që ka arritur kryeministri britanik, Boris Johnson, me bllokun evropian, Qeveria britanike ka mbrojtur marrëveshjen për Brexitin

LONDËR, 1 NËNTOR - Qeveria britanike ka mbrojtur marrëveshjen për Brexitin, apo për largim të Britanisë nga Bashkimi Evropian, pas kritikave të bëra nga presidenti amerikan Donald Trump. Ai ka thënë se Shtetet e Bashkuara "nuk mund të nënshkruajnë marrëveshje me Mbretërinë e Bashkuar" pas marrëveshjes për Brexitin që ka arritur kryeministri britanik, Boris Johnson, me bllokun evropian.

Në muajin gusht, Trumpi pati premtuar "një marrëveshje të madhe" tregtare me Britaninë. Mirëpo, kur ka folur me mbështetësin Nigel Farage në LBC, Trumpi ka kritikuar marrëveshjen që ka arritur Johnson me BE-në. "Ne duam të bëjmë marrëveshje me Britaninë ashtu sikurse dëshirojnë ata. Të jem i sinqertë me ju, kjo marrëveshje, sipas disa pikave, përcakton që nuk mund të bëni tregti. Ne nuk mund të bëjmë marrëveshje tregtare me Britaninë sepse mendoj se mund të fitojmë më shumë sesa tash, dhe shumë më shumë se Britania është duke fituar në Bashkimin Evropian", është shprehur Trumpi. Megjithatë, ai nuk ka dhënë hollësi rreth vështirësive që shihet

për arritjen e marrëveshjes SHBA-Britani.

Mirëpo një zëdhënës i Johnsonit ka thënë se marrëveshja nënkupton se Britania mund të arrijë marrëveshje për tregti të lirë në gjithë botën, me secilin vend që mund të përfitojë ky shtet.

Komente të ngjashme të bëra nga Trumpi kanë shtyrë laburistët ta akuzojnë presidentin amerikan se po tenton "të ndërhyjë në zgjedhje". Duke folur për mediumin LBC, presidenti amerikan ka thënë se Corbyn do të ishte "shumë i keq" në pozitën e kryeministrit derisa, sipas tij, Johnsoni është "njeri i duhur për këtë kohë". Corbyn në anën tjetër e ka akuzuar Trumpin për "tentim të ndërhyrjes" në zgjedhjet e përgjithshme të Britanisë me qëllim të fuqizimit të "shokut të tij Boris Johnson".

Mbretëria e Bashkuar do t'i zhvillojë zgjedhjet më 12 dhjetor, pas shtyrjes së tretë të largimit të Britanisë nga Bashkimi Evropian deri më 31 janar të vitit 2020.

Johnsoni shpreson se do ta fitojë shumicën e ulëseve në mënyrë që ta miratojë në parlament marrëveshjen e arritur me



BE-në, ndërkohë që Corbyn ka premtuar se do të organizojë referendum të ri nëse fiton pozitën e kryeministrit.

Kryeministri britanik Boris Johnson ka thënë në ditën e shpalljes së zgjedhjeve se publiku duhet "të zgjedhë" për të ardhmen e Brexitit, por edhe të gjithë shtetit.

Lideri i laburistëve në Britani, Jeremy Corbyn, është zotuar për

ta "transformuar" Britaninë teksa ka nisur fushatën zgjedhore.

Corbyn ka premtuar se do ta "rindërtojë" shërbimin publik dhe do t'i shënjestrojë "menaxherët e këqij dhe ndotësit e mëdhenj".

Në një fjalim të mbajtur të enjten, ai i ka konsideruar zgjedhjet e 12 dhjetorit si mundësi "të gjeneratës për ta

transformuar shtetin tonë". Corbyn, po ashtu, ka thënë se laburistët do ta lansojnë "fushatën më të madhe në histori".

Vendimi për largim të Britanisë nga blloku evropian ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja kundërshtuar atë në referendumin e mbajtur më 2016.

## Trumpi nuk është më banor i Nju Jorkut

UASHINGTON, 1 NËNTOR - Presidenti Donald Trump tha se ai nuk është më banor i Nju Jorkut. Lajmi u njoftua fillimisht nga gazeta "New York Times" dhe më pas u konfirmua nga vetë presidenti në një seri postimesh në "Twitter". Ai shkruante se ka vendosur që vendbanimi i tij i përhershëm të jetë Palm Beach i Floridës. "Pavarësisht nga fakti se paguaj me miliona dollarë taksa për qytetin dhe në nivel shteti çdo vit, jam trajtuar shumë keq nga drejtuesit politikë të qytetit e shtetit të Nju Jorkut", shkruante Trumpi. Nuk është e qartë se sa është

shuma e taksave që ka paguar Trumpi në Nju Jork, pasi ai refuzon të publikojë informacion mbi këtë çështje.

Guvernatori i Nju Jorkut, Andrew Cuomo, nuk dukej i mërzhitur rreth ndryshimit të adresës së banimit të Trumpit. Ai e quante çlirim nga një barrë dhe shtonte: "Nuk është se Trumpi i paguante taksat këtu gjithsesi. Florida është e gjitha e juaja", shkruante ai.

Në shtator Trumpi dhe bashkëshortja e tij Melania paraqitën dokumente të veçanta vendbanimi në Gjykatën e Qarkut të kontesë së Palm Beach

për ta ndryshuar vendbanimin e tyre.

Sipas rrjetit televiziv NBC, presidenti Trump ka qenë në Mar-a-Lago, rezidenca e tij në Palm Beach, 99 ditë që nga momenti që mori detyrën. Ai ka vizituar klubin e vet të golfit në Nju Xhersi 90 ditë dhe ka shpenzuar vetëm 20 ditë në kullën Trump që ndodhet në qytetin e Nju Jorkut.

Vëzhguesit besojnë se lëvizja e presidentit nga Nju Jorku në Florida ka të ngjarë të jetë pjesërisht e motivuar nga një sistem taksash më të ulëta që zbaton shteti në juglindje të vendit.



**E rrallë**


## Torta me hashash aksidentalisht shërbehet në një funeral në Gjermani

Policia ka njoftuar se një funeral në Gjermaninë Lindore ka përfunduar me drogim të pavullnetshëm të pjesëmarrësve kur atyre iu servua aksidentalisht ëmbëlsira me hashash. Ceremonia vazhdoi në një restorant për kafe dhe tortë, siç është edhe zakoni në Gjermani.



Por, pasi e hëngrën tortën, 13 persona patën mundime dhe marramendje dhe iu deshtë trajtimi mjekësor, raporton AP.

**FOTO E DITES**



Tre këlyshë majmunësh ushqehen nga një kafshë e rritur në një park në Hamburg. /AP/

**E jashtëzakonshme**

## Fshehin drogën me vlerë 200 milionë dollarë në shishet e salcës

Katër persona janë arrestuar në Australi pasi u përpoqën të trafikonin 400 kilogramë metafetaminë. Ata e fshehën drogën në qindra shishe salce. Kutitë që u dërguan nga ShBA në Sidney u deklaruan se përmbanin shishe salce. Por poli-



cia kufitare zbuloi se shisheet përmbanin sasi të madhe droge e njohur si meth, që ka një vlerë mbi 208 milionë dollarë në treg.

**BARSOLETA E DITËS**



- E dashur, më duhet të tregoj një të vërtetë të tmerrshme!, - i thotë burri gruas.  
- Firma ka bankrotuar, babai me la pa hise, veturën e kam bërë përshesh. A do të më dashurosh ende?, - e pyet ai.  
- Do të ndiej për ty, vetëm se do të më mungosh shumë!, - i përgjigjet ajo.



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

### ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.  
Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

### TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.  
Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

### MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.  
Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

### ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**

Nëse po punoni nga shtëpia sot, mos mendoni se nuk do të lodheni.



**DEMI**

Një letër e çuditshme ose telefonatë mund t'ju vijë sot. Mund të jetë lajm i mirë ose i keq.



**BINJAKËT**

Sot duhet të përdorni logjikën. Ju mund të merrni një letër të papritur ose telefonatë që ka të bëjë me paratë.



**GAFORRJA**

Zakonisht ju keni përqendrim të mirë, por sot do të hasni disa pengesa.



**LUANI**

Sot, intuitede juaja mund të dallojë se ka diçka që nuk shkon me mendimet e ndjenjat e vëllait, motrës ose një personi tjetër.



**VIRGJERESHA**

Sot do të merrni një informacion rreth një grupi ku merrni pjesë dhe do të mendoni nëse duhet të qëndroni ende me ta apo jo.



**PESHORJA**

Zakonisht, mendja juaja është e mprehtë dhe e përqendruar, por sot do të kuptoni se nuk mendoni dot në mënyrën e duhur.



**AKREPI**

Zakonisht, ju bazoheni tek intuitede, por sot do ju komandojnë ndjenjat.



**SHIGJETARI**

Sot do të zgjoheni në gjendje jo normale. Kjo sepse, gjatë natës keni parë një ëndërr të çuditshme dhe shqetësuese rreth një miku.



**BRICJAPI**

Mungesa e komunikimit mes jush dhe dikujt tjetër mund të shkaktojë keqkuptime.



**UJORI**

Dita në punë do jetë aq intensive sa nuk do të dëgjoni çfarë ju thonë të tjerët.



**PESHQIT**

Nëse jeni në një lidhje dashurie, do të kuptoni se njëri prej jush është shumë pasionant, por tjetri jo.




## Nicole Scherzinger e lënduar nga vdekja e kushëririt



**N**icole Scherzinger ka bërë një lutje emocionuese për fansat në "Instagram" pasi kushëriri i saj, John Boy, u vra në mënyrë tragjike në një aksident në Fort Lauderdale, Florida, fundjavën e kaluar. "Familja ime dhe unë jemi duke u përgjyruar për çdo informa-

cion që mund të ndihmojë në mbështetjen e hetimit mbi vdekjen tragjike të këtij njeriu të madh", ka shkruar Scherzinger, duke shtuar: "Një makth, që nuk do të jemi në gjendje të zgjohemi", por ngushëllon kur "duke e ditur se ai është në paqe me Zotin".

## Unaza e martesës së Nicki Minajt kushtoi 1.1 milion dollarë



**N**icki Minaj pak kohë më parë zbuloi se ishte martuar me Kenneth Petty. Dhe një postim në "Instagram", reperja ka treguar unazën e martesës që i bleu bashkëshorti. Kenneth e bleu unazën

në argjendarinë "Rafaello & Company" në Nju Jork. Raportohet se unaza me diamant kushtoi 1.1 milion dollarë. 36-vjeçarja u martua me Petty më 19 tetor pas një gati një viti lidhje.



## Angela Martini surprizon fansat, publikon librin e saj të parë në Shqipëri

**A**ngela Martini është një nga modelet shqiptare më të komentuar në mediat rozë si për jetën e saj personale dhe atë profesionale. Ajo prej vitesh jeton në Amerikë ku ka arritur të ketë një karrierë të suksesshme në fushën e modelimit. Së fundmi, modeluesja e njohur shqiptare ka zbuluar në rrjetin

"Instagram" edhe një tjetër pasion, të shkruajë. Ajo ka ndarë me ndjekësit datën e publikimit të librit të saj të parë. "Më në fund erdhi dita, dhe jam shumë e emocionuar të lajmëroj se libri im do të publikohet në vendlindjen time, Shqipëri, më 11 nëntor", ka shkruar Angela përkrah fotos në "Instagram".

## Pse Heidi Klumi është mbretëresha e Halloweenit



**T**ashmë duket se është pranuar nga të gjithë që askush nuk e merr Halloweenin më seriozisht se Heidi Klumi për sa iu përket kostumeve. U bënë shumë vite tashmë që ajo i lë të gjithë gojëhapur me kostumet e sofistikuara aq sa ka

marrë titullin mbretëresha e Halloweenit. Modeluesja gjermane, nënë e katër fëmijëve, e organizoi festën e parë të Halloweenit në vitin 2000 dhe çdo vit ka qenë më ekstravagant se tjetri. Deri tani nuk ka dështuar për asnjë vit.

# Grekomanët dhe spiunimi i

Në vëllimin e katërt të serisë së letërkëmbimeve të Mustafa Krujës me priftin françeskan At Paulinin, ky mund të jetë ndër më interesantët për lexuesin.

Në këtë letër përmendet "Historia e Skënderbeut" e Naim Frashërit, pas botimit të të cilit thuhet se grekët e spinuan Naimin tek Sulltani për librin që "shfrynte kundër turqve vverin e 400 viteve të një populli të pushtuar".

Fort i dashtuni Mik,  
Ket herë kam vonue do kohë per me t'i pergjegjë letres së mbrame, me 24 tetuer. Arsyeya është se kjeçë n'Itali e ndëja aty më se pesë javë. Më patën grishë me marrë pjesë në convegno per studimet shqiptare, qi u mbajt në Palermo me 24-26 tetuer. Rruga shkuem e t'ardhun m'u pague si mue, si edhe gjith të t'ftuemve prej drejtimin të convegno-s. Un prandej, mbasi rruga pague se pague, u nisa prej kndej qysh me 30 Shtatuer e ktheva vetem me 6 nanduer ktû. Nderkaq më kje grumbullue ktû në Graz bajagi postë, pse nuk kishin se si me m'i nisë letrat, tue m'u dashtë me ndrrue shpesh herë adresë neper Itali. Prandej, kur erdha, m'u desht me shkruere shum letra. E tash po i vjen rendi edhe letres s'ate. E tue kenë kjo më e randsishme se tjerat, duhet me e lënë natyrisht në marim, per me u ndalë një grimë më teper në të.

Nuk dij se kû ka me të gjetë kjo leter. Prandej jam tue t'a nisë kso here të rakomandueme. Mue më duket se më ké pasë shkruere një herë tash vonë se keni nder mend me e lënë Egjiptin sá mâ parë e me dalë n'Europë.

N'udhhtimin t'ëm per Itali pata rasë me vizitue trí gjytete qi nuk i kam pasë pá kurr, dmth. Assisi, Napoli e Palermo. Gzohem shum se edhe paçë rasë një herë me pá dý nder kolonit shqiptare të Sicilis, dmth. Mezzojuso e Piana degli Albanesi. Po të kallxoj, si nder kllapa, qi 70% të Piana degli Albanesi janë komuniste. Sivjet e kanë thirrë kryetarin e Bashkis të Piana degli Albanesi në Shqypni e është sjellë atje per tre muej. Ka kthye në Piana e bân propagandë per komuniste. Pata nafakë me e pá edhe ktë me 26 tetuer, qi kje dita e mbrame e kongresit apo e convegno-s, të cilen e kaluem në Piana degli Albanesi. Ishte një


ftyre taman e mbrume e e pjekun per komunizem. Njekso ftyrash zgjedhin perherë të kuqt, pse me ta munden me i ndreqë punët e tyne mâ së mirit.

Por t'i lám të kuqt, pse sot kam per të bâ shum pyetje. Kam lexue e kopjue prej librit t'Anselmo Lorechio, qi nuk më perket mue, shum gjâna mbi Shqipni. Prej kndej po i marr do pyetje.

Si spjegohet puna qi Turkija lëjote shkolla gjithfarësh (greke, serbe, bulgare, rumene) e pengote shkollat shqipe e mâ vonë u çue aq peshë kundra alfabetit latin. Ket punen e dytë e kuptoj mâ mirë. Vorrin Turkis i a bâne njato shtete, shkollat e të cilvet Turkija i lëjote. Shqiptarët janë kenë sugurisht miq mâ të mirë per Turkí se sá Serbët, Grekët, Bulgarët e tjerët.

Lorechio shkruen kështû: "Gli intrighi stranieri e soprattutto le disposizioni arbitrarie (cosa d'altronde inesplicabile) prese dai governanti, hanno privato noi del diritto di avere le nostre scuole nazionali e sempre far arrestare nella maniera piú crudele ogni tentativo a questo scopo". Prap dikund mâ vonë permendë po në të njâjten rasë "bassi intrighi". Mâ vonë, tue folë mbî alfabet, shkruen: "queste contese (per l'alfabeto) erano provocate da intrighi sordi e misteriosi" (Intrigat e hueja dhe sidomos vendimet arbitrarie e të pashpjegueshme, marrun nga qeveritarët, na kanë hequn të drejtën me pasun shkolla kombtare tonat dhe kanë ndalue rreptësisht çdo përpjekje në këtë drejtim" ... "intriga të ulta" ... "këto grindje (për alfabetin) ishin shkaktue nga intriga të heshtuna e të çuditëshme") M' intereson me dijtë kush janë kenë kta të huej qi kanë intrigue e e kanë influencue Turkín në dam të shkollave shqipe.

Në një telegram qi dergojn kapodaít prej Gilan në Stambollë, thohen kto fjalë: "In conseguenza di un malinteso i cannoni e i fucili tuonano da un mese e mezzo in tutte le parti della nostra provincia....". ("Si pasojë e një keqkuptimi topat dhe pushkët gjëmojnë ka



nji muej e gjysëm në të gjitha anët e krahinës tonë") Ky telegram u dergue në korrik 1912.

Il Comitato centrale Albanese "Kombi" kû e ka pasë selin?

Shka thue ti per këto fjalë: "In Albania l'interesse nazionale è sempre andato avanti alle considerazioni religiose" (Në Shqipni interesi kombëtar a është mbajtë gjithmonë para konsideratave fetare)

Qytet i Shkupit a mund të thirrej në kohë të Turkís qytet shqiptar? A njimend zotnonte gjuha shqipe në qytetin e Shkupit?

Aty te Gilani harrova me të plotsue pyetjen, dmth në shka permbahet ky malinteso?

Dikund tjetër thohen prap këto fjalë: "Nel 1204 (vjetët janë alla turca, por sugurisht dhe kjo vjetë kshtu është gabim shtypit!) in seguito ad ordine assurdo ricevuto, Ahmet Mukhtar Pascià si pose in marcia con 20 battaglioni contro Prizreni, ma grazie alle saggie misure prese dal Pascià non fu versato sangue" (Në 1204, mbas një urdhni absurd, Ahmet Mukhtar Pasha filloi të marshojë me njizet batalione kundër Prizrenit por, falë vendimeve të

matuna të Pashës, nuk u derdh gjak). Kúr e n' ç' rasë ndodhi kjo gjâ?

Shka don me thënë fjala Merqes, psh. Merqes di Janina? "Nel Kazá di Luros, cosi nei piani di Perlepi e Florina le terre e le case sono proprietá degli Albanesi" ase "tutte le proprietá sono degli Albanesi". Kuzzo- valaçi e israeliti non possiedono. ("Në Kazánë e Lurës, si dhe në fushat e Përlepit e të Follorinës tokat dhe shtëpitë janë pronë e shqiptarëve"... "të gjitha pronat janë të shqiptarve. Kuco - Vllehët dhe Izraelitët nuk zotërojnë.") A është e vertetë kjo gjâ?

Tash, prej një gurrës tjetër, po nxjerr këto pyetje: "Janina (në kohë të luftës balkanike) rá në dorë, prejsë u thye me pare e trathtoi... ("Janina durch Verrat und Bestechung gefallen" - me kto fjalë tedeshke lajmonte ministrin e vet perfaqesuesi gjerman prej Istambulit). E shton edhe këto fjalë: "Ismail Kemali habe dabei seine Hände im Spiel gehabt" (Ismajl Qemali ka pasë gisht në ket punë). Shka din e shka thue ti per ket punë? E kush kje ai a kush kjén ata qi trathtuen e qi u

thyen me pare në Janinë?


A janë kenë n'ushtrí t'Esat Pashës, qi luftoi në Shkoder kundra Malazezvet e Serbëvet edhe Kristjan, apor ishin të tanë ushtarët musulman? Ket pyetje po t'a bâj jo per tjetër, por vetem pse nder kondita qi Esat Pasha u pat vû Malazezve per dorzimin e Shkodres, kje dhe kjo qi mos me pasë të drejtë Malazezt me kontrolue çfarë elementash kristjan gjinden n'ushtrín e Esat Pashës. Se çfarë randsijet ka mujtë me pasë kjo gjâ, un nuk e kuptoj.

Mue më duket se ket herë të kam bâ pyetje boll. Nji herë tjetër nuk di as vetë se shka me të pyetë, pse mâ i shpika sot.

Prap jam interesue me pyetë per Lambertz. Po qênka tue u shypë blëni I persrí, prandej kuptohet vonesa e madhe.

Kúr e ké menden me dalë n' Europë? Tash po e shof se shi në letren e mbrame po m'a paske shkruere ket gjâ. Po të tokoi me ndejë gjatë n' Europë, m'a merr mendja se ka me na tokue me u pá ndojherë perpara se të bâjsh hapin e madh e të kalojsh pertej oqeanit të hapët. Por tashmâ edhe ky oqean i pamasë po kapërcehet me një orë ajruer. Prandej afer se afer jemi.

# Naim Frashërit te Sulltani



Un nuk kam bâ kurr ndonji hap per me dalë n' Amerikë. Shum e kanë bjerrë shpresen per Europen plakë. Vetë endë nuk e kam bjerrë shpresen n' Europen, qi shum e thrrasin me fjalën tedeshke "Blindarm i Azis". Blindarm shqip është "zorra qorre". Pra, simbas tyne, Europa është zorra qorre e Azis. Mrekullí.

Shum shndet e urime të përzemerta per vjetin e rí, sadoqi heret është tash. Por deri at herë ndoshta nuk do të mundemi me të shkruë mâ. Letra e porositun e émja do të ngjasë shum me të mërrijtë.

Prá edhe njijherë shndet e daulet e urime të perzemerta si per tý si edhe per motren.

Míku i Yt.

P. Margjokaj

Ramleh, 21. I. 1955

Fort i dashuni mik,

U kënaqa për tý për atë udhtim qi paske bâmë n'Italí prej nji skânji në tjetrin. Un mjerisht nuk munda me ardhun. Vërtet biletën do t'mâ kishin paguem edhe mue të shkuem e t'ardhun; por kisha shumë arsye tjera qi më penguen. Shëndosh për tjetër herë. Ti je vrojs i mirë e të falem nderës për ato pak

allogjenë të mbretnisë? Un e kuptoj kështu:

Çdo e drejtë ka konsistencë kur njeriu qi duhet t'a ketë e ndien, e din e e çëmon. Ndryshe e drejta nuk eksiston. E kanë ndiem, e kanë kuptuem, e kanë çëmuem Shqiptarët të drejtën për shkolla shqip? Njiqindmijë jo, nji po : do me thënë jo.

Na s'kemi pasun kurrë, jo shkolla, por as shkrim t'onin. Kur nji elite të vogël i rá ndër mënd për të aty kah 1870 e sa, i pari alfabet shqip u sajue shi në Stamboll me lejën e sulltanit. Gjithashtu u çel edhe nji shkollë shqip në Korçë. Shqiptarët nisën me shkruem. Në mos u gabofsha - se s'kam burime këtu për me kontrolluem hollsitë - në 1880 u botue e famshmjia "Historí" e Skënderbeut prej Neim Frashërit. Grekët u nxituen me i a raportuem fill e për pë Sulltanit. Dhe kishin ç'i raportojshin! Se ajo s'ishte as historí, por nji libello qi shfrente kundra Tyrqet vënerin e katërqind vjete të nji populli të pushtuem ashtu siç e ndiente, jo vetë ai popull, por auktori. Prûna vetëm nji shembull, por në letërsinë jugore, të botueme përjashta, ke sa të duesh edhe tjerë qi tregojnë se ç'synojshin intelektualët shqiptarë, se ku dojshin me dalë nëpër shkollat kombtare në gjuhë shqipe. Sikur shkrimi shqip, letërsija shqipe të kishte pasë nisun e vazhduem me vepra si Lahuta e Malcisë në të cilën shqiptarët gjithkund luftojnë "për mbret e troje të veta" e "të bardhën fé", kush mundet me thënë se na nuk do të kishim pasun shkollat t'ona në gjuhën t'onë, librat t'anë e gazetatat t'ona, jo vetëm lirisht, por edhe të nxitun e të sub-

vencjonuem prej shtetit othoman? Vënu ti në thronin e Abdylit e gjyko në se ka faj, sidomos tue marrë para s'sh se ndërsa shkrimet e Neim Frashërit me shokë ka pasun plot kush me t'i raportuem e me komentime të rafinueme, e ato të kokave të randa si Fishta me shokë jo. Un në të ritë t'em i kam kënduem me entusjajzëm e tue derdhun lot veprat e Neimit. Por sot i gjykoj historikisht. Pra këndej del edhe qi të drejtën duhet jo vetëm t'a keshë ndiem, kuptuem e çëmuem, por edhe të dijshe me e përdorë. Tjerë të huej, veç Greket, un s'besoj qi kanë bâmë intriga kundra gjuhës s'onë. Por besoj se do të ketë pasun Shqiptarë të poshtër, këta po, qi kanë menduem vetëm për interesat personale qi mund të biershin e mâ fort ato qi do të fitojshin tue trathtuem kombin e vet. Kush ka qënë? X-i e Y-i et. a në dash thuej dreqi e i biri!

"... i canioni e i fucili tuonano.. eç." i referohet sigurisht kryengritjes së Kosovës. "Malinteso" këtu është fjala për nji shprehje diplomatike, besoj un.

Un s'besoj se ka pasun nji komitet shqiptar Kombi: gazetë me kët' emën po, por komitet jo. Ndoshta nji patrijot a nji grusht ksish kanë mujtun me përdorë nji emën të këtilë për të impresjonuem ke ka qënë nevoja. Æsht nji systemë revolucjonare të pafuqishmish qi e kam përdorë edhe vetë në 1910. Unë e kam besuem gjithmonë se ndër Shqiptarë instinkti racial ka qënë mâ i fortë se ndiesija fetare, por jo "interesa kombtare", të cilën ata s'e kuptojnë as sod. Këtu s'po shkoj

mâ gjatë, se besoj se ndryshimi ndërmjet dýshprehsvet kuptohet lehtë.

Shkupi, nën sündimin othoman, ka mujtun me arsye me u quejtun qytet shqiptar. Posë qi afërsinat e tij kanë qënë me shumicë shqiptare, kujtoj se i tilë ka qënë edhe vetë. Influenca shqiptare ka qënë sigurisht mâ e fortë në Shkup se ajo e çdo elementi tjetër.

Ça i përket Ahmet-Muhtar Pashës do të ketë ndodhun kundra Lidhjes së Prizrendit (1878-1881). Me ato të dhâna qi gjëj në letrën t'ânde, un kështu mund t'a zgjidh atë problemë algjebrike.

Merqez = qëndër, kryevënd, kryeqytet, selí etj, simbas rasës. "Nel Kazá di Luroshetc" do t'i afrohet mjaft së vërtetës.

Për Janinën un nuk di kurr gjá të sigurtë, madje nuk di veçse çançat qi vijshin rrotull aso kohe e që ishin në gojë të gjithë kundrështare të Ismail-Kemalit. Dij qi ky ka dekun pa ovull në xhep e qi në Vlonë pranë tij kanë qënë Luigj Gurakuqi, D. Nikoll Kaçorri e sa patrijotë tjerë të panjollë.

Mbas dokumentit qi po më thue, duhet të kenë qënë ndoshta edhe të krishtënë me Esatin në Shkodër, sado pak e ushtarë (luftarë) apo civila. Un me fakte nuk di gjá. Rândsij'e kushtit t'Esadit është kjo, qi në Shkodër po h?nte Mali i Zi e, pa atë kusht, të krishtënë të kishin qënë në shërbim të tij do të pësojshin dame e ndëshkime.

Përgjegjet i mbarova shi ku duhet e për tjera s'po kap nji copë letër tjetër mâ, por mirë se të flasim nji tjetër herë kur të më keshë shkruë ti, e tu mirë qofsh. /Standard/



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

## Sot derbi Feronikeli - Ballkani, debuton trajneri Sopi

Kampioni në fuqi, Feronikeli dhe kryesuesi aktual i Superligës, Ballkani, sot (e shtunë) do ta ndajnë mejdani për herë të dytë në këtë kampionat. Në ndeshjen e parë të zhvilluar në Suharekë fitues kishte dalë Ballkani (3-1), kurse sot "Nikli" me trajnerin e ri synon t'ia kthejë borxhin skuadrës kryesuese



Prishtina kërkon tri pikë në Klinë

FC Prishtina sot (e shtunë) është mysafire e skuadrës së Dukagjinit. Mbrojtësi i kryeqytetasve, Ahmet Haliti, ka thënë se synim i Prishtinës në Klinë është fitorja. "Ekipi po vazhdon të ketë formë të lartë bashkëngjitur edhe atmosferën shumë të mirë që po mbizotëron në skuadër. Vijnë pas disa rezultateve tejet pozitive. Kemi qëllim për ta vazhduar ende, edhe në ndeshjen në Klinë. Ndërsa Dukagjini, edhe pse nuk po gëzon formë të mirë, ka disa individë në përbërjen e vet shumë të mirë, të cilëve nuk duhet t'u japim

hapësirë. Ne duhet ta kryejmë punën tonë, ta përmbushim obligimin që t'i arkëtojmë tri pikë dhe të jemi të qetë para derbit me Feronikelin. Jam optimist, i besoj formës dhe cilësive tona se do t'i marrim pikët e plota në Klinë", ka shtuar Haliti.

### Llapi ndal serinë e suksesshme të Drenicës

Skuadra e Llapit, pas dy humbjeve, është këndellur në përballje me Drenicën të cilën e ka fituar me rezultat minimal 1-0. Dhjetë minuta i kanë mjaftuar skuadrës që drejtohet nga Tahir Batatina për të kaluar në epërsi. Autor i golit ishte

**IPKO SUPERLIGA**

Llapi - Drenica 1-0

Të shtunën takohen:  
13:00 Trepça '89 - Vushtrria  
13:00 Feronikeli - Ballkani  
13:00 Dukagjini - Prishtina

Të dielën takohen:  
13:00 Gjilani - Ferizaj  
13:00 Flamurtari - Drita

**LIGA E PARË**

Të shtunën takohen:  
Trepça - Dardana  
Istogu - Arbëria  
Liria - Vëllaznimi  
Ramiz Sadiku - Malisheva  
Ulpiana - Vitia

Të dielën takohen:  
Onix - Vllaznia  
Drenasi - KEK-u  
2 Korriku - Besa

Mentor Zhdrella, kurse pjesa e parë përfundoi 1-0. Në pjesën e dytë të dyja skuadrat patën edhe disa raste shënimi, por rezultati mbeti i pandryshuar dhe në fund pikët mbetën në Podujevë. Në anën tjetër, Drenica pëson humbje pas pesë ndeshjeve. Pas kësaj ndeshje Llapi ngrihet në kuotën e 23 pikëve dhe zë vendin e pestë, kurse Drenica është e shtata me 17 pikë.

### EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 1 NËNTOR** - Derbi i javës së trembëdhjetë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll në mes të Feronikelit dhe Ballkanit zhvillohet sot (e shtunë) nga ora 13:00. Kjo ndeshje është e veçantë për skuadrën kampione nga Drenasi, pasi debuton trajneri i ri Agim Sopi, i cili e zëvendëson Dejan Vukiqeviq. "Nikli" një ditë para kësaj ndeshje e prezantoi trajnerin e ri, me të cilin synon t'u rikthehet rezultateve pozitive, pikërisht në një ndeshje derbi ndaj kryesuesit aktual të elitës, Ballkanit. Gazeta ka kontaktuar disa prej futbollistëve të Feronikelit, por ata nuk kanë qenë të gatshëm të flasin për ndeshjen e sotme, pasi klubi ka marrë vendim që ata të mos deklarohen për medie. Për ndeshjen që zhvillohet në sta-

diumin "Rexhep Rexhepi" ka folur kapiteni i Ballkanit, Visar Berisha, i cili ka lënë të nënkuptohet se skuadra e drejtuar nga Ismet Munishi në secilën ndeshje kërkon fitore. "Aktualisht jemi liderë falë formës, disiplinës dhe harmonizimit të mirë të ekipit. Çdo ndeshjeje i qasemi me përkushtim maksimal. Kjo ka bërë që ne tani të jemi më lart se ekipet e tjera. Edhe ndeshjen e radhës do ta marrim me përkushtim maksimal dhe do t'i qasemi ashtu si ndeshjeve të tjera", ka thënë Berisha.

Në ndeshjen e parë të zhvilluar në Suharekë, fituese kishte dalë skuadra e Ballkanit me rezultat 3-1. Pas 12 xhirove të zhvilluara është skuadra e Ballkanit ajo që dominon në Superligë me 26 pikë të grumbulluara, kurse "Nikli" është shtatë pikë prapa kryesuesve dhe renditet në vendin e gjashtë.

## Ndeshje interesante në basketboll

**PRISHTINË, 1 NËNTOR** - Xhiroja e tetë në Superligën e Kosovës në basketboll do të hapet me ndeshjen ndërmjet rivalëve të vjetër të basketbollit të Kosovës, Bashkimit dhe Sigal Prishtinës. Prizrenasit kanë katër fitore dhe dy humbje në këtë edicion, derisa prishtinasit, pesë fitore dhe një humbje. Të dielën do të zhvillohen tri ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje. Golden Eagle Ylli, që vjen me ndryshime në shtabin teknik, do të përballet me Pejën. Therandasit kanë katër fitore dhe dy humbje në këtë edicion, kurse pejanët kanë tri fitore dhe tri humbje. Ndeshje shumë interesante pritet të jetë edhe ajo ndërmjet Trepçës dhe Feronikelit. Mitrovicasit nga gjashtë ndeshje kanë një fitore dhe pesë humbje,



kurse skuadra nga Drenasi, që debuton në Superligë, ka dy fitore dhe katër humbje. Xhiroja e tetë përmbyllet me sfidën ndërmjet Rahovecit dhe Ponte Prizrenit. Vreshtarët kanë pesë fitore dhe një humbje, kurse skuadra nga Prizreni ka katër fitore dhe tri humbje.

### SUPERLIGA - basketboll

Të shtunën takohen:  
19:00 Bashkimi - Sigal Prishtina

Të dielën takohen:  
17:00 Golden Eagle Ylli - Peja  
19:00 Trepça - Feronikeli  
21:00 Rahoveci - Ponte Prizreni

## Sopi, trajner i Feronikelit



**DRENAS, 1 NËNTOR** - Skuadra kampione e Kosovës në futboll, Feronikeli, e ka prezantuar trajnerin e ri. Pasardhës i Dejan Vukiqeviqit do të jetë Agim Sopi. Ky i fundit e ka stërvitur të premtën skuadrën në stadiumin "Rexhep Rexhepi" dhe është njoftuar me futbollistët. "Trajneri Agim Sopi është i njohur për kualifikimin e skuadrës së Maqedonisë së Veriut U21 në Kampionatin Evropian në rolin e trajnerit gjatë viteve 2014-2017. Para se ta merrte drejtimin e skuadrës së FC

Feronikelit, Sopi drejtoi skuadrën suedeze Landskrona. Ai është i lindur në Shkup në vitin 1969, me prejardhje nga Kosova, por që jeton në Suedi që një kohë të gjatë. Sopi është trajner me karakter sulmues, ku formacioni i tij i preferuar është 4-2-3-1, i cili i përshtatet me përpikëri skuadrës tonë", thuhet në njoftimin e Feronikelit. Skuadra e "Niklit", që është kampione në fuqi dhe fituese e Kupës, aktualisht pozicionohet në vendin e gjashtë me 19 pikë të grumbulluara.

## Kosova, fanella speciale ndaj Çekisë

**PRISHTINË, 1 NËNTOR** - Përfaqësuesja e Kosovës do t'i luajë dy ndeshje tejet të rëndësishme në muajin nëntor. Fillimisht dardanët do të udhë-

tojnë për në Çeki për t'u ndeshur me kombëtaren çeke, që pritet të jetë një ndeshje finale për Kosovën, në rrugën e saj për një kualifikim për në

Evropian. Tri ditë më vonë, në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, Kosova do ta presë kombëtaren angleze. Kompania që merret me diza-

gnimin e fanellave të Kosovës të premtën ka prezantuar fanellën speciale të cilën dardanët do ta bartin në ndeshjen ndaj Çekisë.



## 'Zbuten' tifozët e Arsenalit, megjithatë trajneri lë jashtë skuadre Xhakën

LONDËR, 1 NËNTOR - Menjëherë pasi Granit Xhaka bëri gjeste të pahijshme, duke nxitur tifozët e Arsenalit për vërshëllimat, të gjithë ishin të një mendje: "Të përjashtohet". Tifozët e Arsenalit nuk kënaqeshin vetëm me heqjen e shiritit të

kapitenit, por donin edhe largimin e mesfushorit me origjinë shqiptare. Derisa erdhi reagimi i Xhakës ku shprehej se kishte marrë kërcënime për gruan, veten edhe njerëz që uronin kancerin për vajzën e por-salindur. Në kushte të tilla

edhe tifozët e Arsenalit kthehen në njerëzorë dhe në rrjetet sociale ka pasur mbështetje në orët e fundit për ta kthyer Xhakën në formacion. "Si fillim rëndësi ka njeriu dhe si çdo njeri, Xhaka ka ndjenjat e tij dhe i duhet kohë që të rikthehet

në normalitet. Ai kërkoi falje ndaj tifozëve dhe të gjithëve. Nuk e kam në plan nesër dhe nuk mendoj se do të luajë. Tani Xhaka duhet ta lërë pas këtë çast dhe të përqendrohet 100 % në fushën e lojës", ka thënë trajneri Uani Emery.



## Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit shënoi 40-vjetorin e themelimit

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit të premtën ka shënuar 40-vjetorin e themelimit ku ka organizuar konferencën e dytë shkencore. Shumë profesorë të huaj, si dhe nga Kosova, ishin të pranishëm në këtë organizim. Nuk mungoi as kampionia olimpikë e xhudos, Majlinda Kelmendi dhe trajneri i saj Driton Kuka.

Dekani i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, Musa Selimi, ka thënë se sot u mbushën gjithsej 40 vjet udhëtim që nga themelimi i këtij fakulteti. "Sot 40 vjet rrugëtim që nga viti 1979, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit po kujton dhe numëron kohën e bashkë me të edhe sukseset. Dita e sotme, 1 nëntor 2019, për studentët, pedagogët, prorektorët e fakultetit, por edhe për të gjithë Universitetin e Prishtinës, është një krenari e shumëfishtë. Është një kremte e shumëfishtë. Sot këtu, me mysafirë shumë të veçantë, me mjeshtër të pendës, studiues, hulumtues publicistë, sportistë, veteranë, media të shkruara dhe elektronike, po shënojmë një ngjarje të veçantë, 40 vjet dije në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit. Është një moment që koincidon me vllugun e aktivitetëve tona. Që të shohim se vërtetë se nga kemi filluar, ku kemi arritur dhe cili është rrugëtimi dhe vizioni për ardhmërinë e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sportit", ka thënë Selimi.



Barbara Wesner, profesoreshë nga Universiteti i Vjenës, ka thënë se në këtë 40-vjetor ky fakultet duhet të jetë shumë krenar për të arriturat e studentëve sepse po e ngrehnin lart flamurin e Kosovës në garat ndërkombëtare. "Vërtet jam shumë e lumtur që jam pjesë e këtij përparimi, këtij progresi dhe ndryshimeve të cilat veç që kanë ndodhur brenda 10 vjetëve të fundit. Jam pjesë e këtij rrugëtimi. Me të vërtetë është e jashtëzakonshme të shihet se përbrenda këtyre projekteve të përbashkëta kemi hapur mendjet tona jo vetëm që ta shohim ndikimin e sporteve, por gjithashtu të hapim mendje për sektorin e shëndetësisë, që është shumë i rëndësishëm. Po e shijoj me të vërtetë faktin se studentët e Universitetit të Prishtinës po dalin jashtë shtetit dhe ju duhet të jeni shumë krenarë me studentët tuaj", u shpreh Wesner.

Kampionia olimpikë e xhudos, Majlinda Kelmendi, uroi për 40-vjetorin e themelimit të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit në emër të të gjithë sportistëve. Ajo dha një mesazh për gjininë femërore. "Në emër të gjithë sportistëve të Kosovës, urime 40-vjetorin e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit. Ju përgëzoj dhe ju falënderoj për mundin dhe për sakrificën që e bëni çdo ditë me qëllim të edukimit dhe të vetëdijesimit të të rinjve të Kosovës. Një përvojë që e kam pasur në një universitet privat në Kosovë, kam vërejtur që numri i gjinisë femërore, në krahasim me gjininë mashkullore në Fakultetin e Kulturës Fizike, është mjaft i vogël. Nuk do të thotë që duhet me qenë sportist që me qenë pjesë e këtij fakulteti, kështu që mesazhi im për femrat është që, nëse kjo është ajo që ju pëlqen, të mos hezitoni aspak", ka thënë Kelmendi.

## Clippersat kalojnë San Antonion, fitojnë Miami dhe New Orleansi

LOS ANGELES, 1 NËNTOR - Ishin vetëm tri ndeshje në NBA. Spikat fitorja e Los Angeles Clippersit ndaj San Antonio Spursit. Në "Staples Center" skuadra kaliforniane regjistroi fitoren e katërt sezonale në gjashtë takime dhe njëkohësisht i shkaktoi humbjen e parë formacionit teksan që vinte në këtë sfidë pas tri suksesesh. Rezultati i sfidës ishte 103-97 në favor të Clippersit dhe meritat shkojnë të gjitha për ish-in e madh Kawhi Leonard i cili ishte fantastik në këtë fitore të skuadrës nga Los Angelesi me 38 pikë, 12



rebounde dhe 1 asistim. Te Spursi më i miri mbi parket ishte DeMare DeRozan me 29 pikë, 7 rikuperime dhe 2 asistime. Vazhdon forma e mirë e Miami Heat që mori fitoren e katërt në pesë takimet e fundit falë suksesit me shifrat 97-106 në shtëpinë e Atlanta Hawksit, që

nga ana tjetër është në krizë pasi pësoi disfatën e tretë rresht, raporton "SS". Në "State Farm Arena" të Atlantës, skuadra nga Georgia ishte e pafuqishme për ta ndalur formacionin nga Florida me Miamin që iu fal edhe 28 pikëve të realizuara nga Nunn, ndërkohë që vendësit vuajtën mungesën e yllit të tyre Trade Young për arsye dëmtimi. Pas katër humbesh regjistroi fitoren e parë në këtë sezon New Orleans Pelicansi që mposhti me rezultatin e thellë 122-107 Denver Nuggetsit. Okafor me 26 pikë dhe Brandon Ingram me 25 pikë ishin dy heronjtë e Pelicansit në këtë sfidë.

### SHKURT

#### Verstappen: Hamiltoni ma ka frikën

Ditën e diel do të zhvillohet në pistën e Austinit gara e Çmimit të Madh të Amerikës në Formula 1. Kjo është gara numër 100 për pilotin holandez Max Verstappen që ka përfunduar në qendër të polemikave pas garës së fundit në Meksikë. Piloti i Red Bullit është kritikuar nga mjaft kolegë, përfshirë edhe Lewis Hamiltonin, për sjelljen e tij në pistë dhe kontaktin që ata patën në garën e fundit. "Nuk e kam goditur në garën e fundit, nuk e kam dëgjuar këtë gjë nga ai. Gjithsesi, më duket një deklaratë idiote. Unë jam përqendruar te gara ime, puna ime. Nuk kam pasur shumë raste të dueloj në pistë me Hamiltonin, por sa herë që kemi qenë rivalë kam treguar se jam më i mirë se ai. Ndoshta ai më ka frikë, ndaj flet ashtu për mua", ka thënë Max Verstappen.

#### Zidane: Bale nuk largohet nga Reali

Zinedine Zidane u është përgjigjur spekulimeve për një largim të mundshëm të Gareth Bales gjatë janarit nga Real Madridi. Trajneri francez është shprehur i bindur se ai do të qëndrojë në Madrid. "Largimi eventual i Balet i përket së kaluarës. Ai është këtu dhe është në fushë, po luan dhe po ushtron. Ne jemi me të dhe e presim në ekip. Asgjë më shumë. Nuk më duhet të bëj asgjë tjetër. Nuk kam nevojë ta bind atë për asgjë sepse ai është këtu", ka thënë Zidane.

#### Udinese shkarkon Tudorin, pëlqehet Gattuso

Skuadra e Udineses e ka zyrtarizuar lajmin për shkarkimin e trajnerit Igor Tudor. "Bardhezinjtë" po kalonin një formë shumë të dobët në këtë fillim kampionati, teksa vetëm në dy ndeshjet e fundit u mposhtën 7-1 nga Atalanta dhe 4-0 nga Roma. Pikërisht për këtë drejtuesit vendosën ta shkarkojnë nga posti i trajnerit Igor Tudor dhe tashmë janë në kërkim të një trajneri të ri për ta marrë vendin e kroatit. Sipas mediave italiane, alternativa e parë për ta marrë vendin e 41-vjeçarit është Gennaro Gattuso.

#### Cavani mendon largimin nga PSG-ja

Sulmuesi Edison Cavani është duke e menduar largimin nga Paris Saint-Germaini, njofton "L'Equipe". Sulmuesi nga Uruguai ka mbetur në bankën rezervë që prej ardhjes së Mauro Icardit nga Interi dhe kjo situatë duket e papërbalueshme për Cavanin, i cili pritet të largohet nga PSG-ja në afatin kalimtar të janarit. Cavani nga viti 2013 është pjesë e PSG-së, kurse për këtë klub ka shënuar 136 gola.

#### Vidali refuzon një superofertë për Interin

Mesfushori i Barcelonës, Arturo Vidal, thuhet se dëshiron transferimin tek Interi në afatin e janarit. Vidal u transferua nga Bayerni te Barcelona para dy sezonesh, por ka dështuar të zë një vend titullari. Situata si zëvendësues nuk po i pëlqen aspak kilianit dhe ai po mendon largimin nga "Camp Nou" në afatin dimëror. Klubet kineze, në veçanti Shanghai SIPG, ka bërë gati ofertën për Vidalin, por lojtari e ka refuzuar këtë mundësi. Sipas mediumit italian "InterNews", ylli i Barcelonës është i gatshëm të heqë dorë nga kjo ofertë fitimprurëse për mundësinë për të luajtur për Interin. Kiliani është i interesuar të punojë përsëri me Antonio Conten, ish-trajnerin e tij te Juventusit.



<b>Autor:</b> <b>GAZMEND MORINA</b>	ATDHETARI NË FOTO	KËNGËTARJA TOSKA	▼	NJERI QË MERRËT ME NJË ZANAT A MJESHTERI THEMBRA E KËPUCËS	KARROÇË E HAPUR ME KATËR RROTA, E TËRHEQUR PREJ KUAJSH	RENS ISTVUD	ZANORE	<b>EPOKA ERE</b>	DÏCKA E MËRZITSHME, NGAQË PËRSËRITET GJITHNJË	HUMBAS NJOMËSINË, FORCËN, GJALLËRINË DHE SHËNDËTIN	FLORIRI
DEGË E NJOMË, E GJATË, E HOLLË DHE E DREJTË, FILIZ (shq.)								ISH AKTORJA AMERIKANE GARDNER POEZIA E DASHURISË			
PLAKU ME PËRVOJË, QË MERRËJ SI GJYQATAR NË NJË ÇËSHTJE							FUTBOLLISTI ARGJENTINAS .... BANEGA (VALENCIA) AKUZUES I SOKRATIT				
VENDLINDJA E ODISEUT							KËNGËTARJA LUAR ..... LIBËR FILLESTAR				
GJOJS				BIMË E VENDEVE TË NXEHTA (shq.) FUTBOLLISTI FRANCEZ ..... DIARRA							ARKEOLUG YNË SKËNDER
SHËNIM NË FUTBOLL				EMËR MASHKULLI MYSLIMAN GROSS TONNAGE REGISTER					TONI ADAMS SËPATË E VOGËL		
U SPËRKAT ME UJË					HIDROKARBUR I PANGOPUR E MPAKUR						
MUNDËSI, SHANS (sh.shq.)								THIKA QË MBAHEJ SI ARMË BREZI TATUAZH (bised.)			
<b>EPOKA ERE</b>	MËSIM PRAKTIK OSE TEORIK	FUSHËBETEJA	FUTBOLLISTI LIONEL ....	INDIUM	"... TAK"	ARMENIA	USHTRI (sh.shq.) ZANORE				BASHKËT. HUQI, VESI
KONFERENCË NDERKOM-BËTARE NË RANG PRESIDENT-ËSH						TRUP GJEOMETRIK PORTOFOLI		EPOKË (shq.) VLERËSIM ME NOTË		GURRA FILM I AKTORIT BEN AFFLECK	
LUMË NË KOSOVË						SONDAZHI KLUB FUTBOLLI NË SPANJË				ALUMIN VARG MALESH TË LARTA (sh.shq.)	
PIKË A VEND NË QENDËR TË DIÇKAJE				BASKETBOLLISTI YNË ERMAL ..... KOHË			DY ZANORE		NJË PLANET E BËRA COPE-COPE NJË LETËR		
▶				DRU PYLLI I LARTË ATË			NUMËR THEMELOR BANORET E NJË SHTETI SKANDINAV			GIRLS LEADERSHIP INSTITUTE SHTEGU	LLOJ REVOLJEJE
BËRJE MË I RI NYNBERG, AUGSBURG			ORDER BRITISH EMPIRE BURRË SHTETI (shq.)			SHOUMENI KRASTA		VRIMË E MADHE DHE E THELLË (sh.shq.) PEMË E VENDEVE TROPIKALE			
ZANORE		TRUP I NJERIU NGA KOKA DERI TE KËMBËT SHKENCA MBI PAQEN				LLOJ SHALE DRURI KLUB FUTBOLLI NË ITALI				ZANORE SMALT	TOTENHAM AI QË ZOTËRON NJË PASURI A DIÇKA TJETËR
CEREMONI FETARE			QEN I MURRMË, MURRASH FORTESE				BEREQETI				PREVA DEGËT E TEPËRTA TË NJË PEME
<b>EPOKA ERE</b>	ANALISTI POLITIK BLERIM FJALA E DHËNË PËR DIÇKA					OKSIGJEN, NEON SHTËPI PLEQSH (shq.)		LUFTËTARI ..... VOKSHI OLIVIA MUNN		DY BASHKËTINGËLLORE QYTETI ITALIAN I MODËS	
AKTORJA UELLSIANE CATHERINE .... JONES				FEMRA LUFTËTARE (mit. greke) I FILLOVA					HYJNI E DASHURISË NË MITOLOGJINË ROMAKE PJJATA		
▶						SOLISTJA ... BYTYQI VEPËR E KRIMINELIT			PARIA E SHOQËRISË MBAJTJE E ANËS		
KRYEVEPRA E LEONARDO DA VINÇIT DESPOTIZËM						KASTRIOT TUSHA PËREMËR PRONOR		KLUB FUTBOLLI NË ARGJENTINË "... LORENZO" KËNGË E POPULLARIZUAR		"LISERA" TEDI ALVES	
DY (turq.)			MUZIKANTI ... BAJRI DY ZANORE				BASHKËT. LËRE (bised.)		PJESA E ERRËT E DITËS BREJTËS I VOGËL		ZANORE ANNA RUSO
MIMOZA AHMETI			SHKOMBËT-ARIZIMI DYRRAHU						RROGË VJETORE E PAPËS INDIA		
IRLANDA		KUNDREJT URREJ				PËRHAPJA E VALËVE				NJËSI KOHE	

**Lume's Details**

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjeipuneshpeite

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

► Ismet Ujkan Uka shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII, SHF "Shotë Galica" Runik.

► Valmir Ajeti shpall të pavlefshme diplomën e SHFM "Anton Çetta" Skenderaj.

► Fadil Alija shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Angjellko Pacollaj shpall te pavlefshme dëftesat e vitit I,II shme "Ymer Prizreni" Prizren

► Angjellko Pacollaj shpall te pavlefshme dëftesat e vitit III dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Bekim Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Motrat Qirazi" Prizren

► Urgjentisht kërkoh një banesë për blerje ne Prishtine me dy dhoma gjumi. Informatat në tel: 044 741 155.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoh një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

► Shesim banesën dy dhomshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtime i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit, çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria -Vlada-Government*



*Ministria e Mbrojtjes*  
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense  
Drejtoria e Burimeve Njerëzore / Direktorat Ljudskih Resurs  
Human Resources Directorate

# KONKURS

**PËR REKRUTIMIN E KADETËVE PËR SHKOLLIM NË AKADEMINË E FORCAVE AJRORE  
DHE AKADEMINË USHTARAKE –WEST POINT TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS**

**Afati i konkurimit:**

**Konkursi është i hapur prej 22.10.2019 deri më 04.11.2019.**

**Ministria e Mbrojtjes iu shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës  
dhe mirëpret aplikacionet e të gjithë kandidatëve të interesuar  
pa dallim gjinie, race dhe përkatësie etnike.**

Konkursi dhe formularët për aplikim janë në dispozicion në Komandën e Forcave Tokësore  
dhe në ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes, [www.mod.rks-gov.net](http://www.mod.rks-gov.net).  
Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr.tel. 038-603-355.

